

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSIT**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**



**FAKULTETI JURIDIK**  
**FACULTY OF LAW**  
**ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ**

**STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË**

**DREJTIMI PENAL**

**TEMA:**

**“DËNIMI I BASHKËKRYERËSVE TË VEPRAVE PENALE NË PRAKTIKEN GJYQËSORE  
TË GJYKATËS THEMELORE NË GOSTIVAR (2015-2020)”**

**Kandidat:**

**Merhata Memedi Shatri**  
**Ratkoceri**

**Mentor:**

**Doc. Dr. Vedije**

**Tetovë, 2022**

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës së magjistraturës së paraqitur është punë origjinale e shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota.

Me respekt

---

Merhata Memedi Shatri

## **FALËNDERIM**

Një falënderim i veçantë i takon mentorit tim Doc. Dr. Vedije Ratkoceri për ndihmën dhe sugjerimet konkrete gjatë përgatitjes së këtij punimi, gjithashtu edhe anëtarëve të komisionit.

Falënderoj personat që më ndihmuan që të realizoj këtë punim, që nuk kanë qenë pak në numër, por një numër më i madh, që unë me sukses të arrij të realizoj këtë rrugëtim të gjatë timin, pa të cilët nuk do të ishte i mundur realizimi i këtij punimi.

Falënderime të thella i shpreh familjes sime dhe të gjithë atyre që më kanë përkrahur.

## **PËRMBAJTJA**

ABSTRAKTI	7
QËLLIMET E HULUMTIMIT	10
HIPOTEZAT	11
RËNDËSIA E PUNIMIT	13
KAPITULLI I	15
Njohuri të përgjithshme mbi veprat penale të kryera në bashkëpunim	15
1. Njohuri të përgjithshme mbi institutin e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale	15
2. Kuptimi i veprave penale të kryera në bashkëpunim	19
3. Historiku i veprave penale të kryera në bashkëpunim	23
4.1 Bashkëkryerësi	31
4. LLOJET E BASHKËPUNËTORËVE	35
4.2 Nxitësi	39
4.3 Ndhmësi	42
5. FORMAT E BASHKËPUNIMIT	45
5.1 Bashkëpunimi i thjeshtë	46
5.2 Bashkëpunimi i veçantë	47
KAPITULLI II	50
PËRGJËGJESIA E BASHKËPUNËTORËVE NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE	50
1. Kodi Penal i RMV	50
2. Ligji i procedurës penale i RMV	53
3. Legjislacioni penal për krimin e organizuar	53
4. Aktet ndërkombëtare	57
5. Konventat ndërkombëtare	59
6. Përgjegjësia penale dhe caktimi i dënimit për bashkëpunëtorët në bashkëpunimin e thjeshtë	61
KAPITULLI III	63
Aspekte krahasimore të veprave penale të kryera në bashkëpunim dhe dënimet e bashkëkryerësve të veprave penale në praktikën gjyqësore me vendet fqinje	63
1. Dënimet e bashkëkryerësve të veprave penale në praktikën gjyqësore në Kosovë	63
2. Dënimet e bashkëkryerësve të veprave penale në praktikën gjyqësore në Shqipëri	68

3.Dënimet e bashkëkryerësve të veprave penale në praktikën gjyqësore në Kroaci	71
KAPITULLI IV	74
Studim empirik	74
Të dhëna nga Gjykata themelore në Gostivar për aktgjykimet e krimeve të ndryshme të kryera në bashkëkryerje	74
Vëllimi dhe dinamika e veprave penale të ndryshme të kryera në bashkëkryerje	74
Veprave penale të ndryshme të kryera në bashkëkryerje	74
Recidivizmi paraqet një formë të vecantë dhe të rrezikshme të kriminalitetit.	77
Gjinia	77
Faktorët ekonomik social me ndikim në kryerjen e veprës penale të në bashkepunim	79
Kriza ekonomike	79
Varfëria	79
Kushtet e vështira materiale për jetesë	79
Të dhëna nga Gjykata themelore në Gostivar e Tetovë për aktgjykimet e krimeve të ndryshme për dënimet e shqiptuara ndaj bashkëkryerësit	80
Aktgjykimi KM.nr 46/11	86
Aktgjykimi KM.nr 17/12	86

## ABSTRAKTI

Për të bërë një punë të përsosur, gjithmonë puna ekipore dhe bashkëpunimi me më shumë persona ka dhe suksesin më të madh. Sot në botën bashkëkohore në çdo interviste pune, gati përherë një ndër pyetjet primare është a jeni i gatshëm dhe a mund të përshtateni me punë në ekipë pikërisht për arritje të rezultateve dhe qëllimeve më të mira.

Mirëpo, ky bashkëpunim dhe bashkimi i më shumë personave që të arrhet deri te caku i përgatitur apo qëllimi i caktuar si dhe i rezultateve të “shkëlqyera”, kur kemi të bëjmë me kriminalitetin, paraqet rrezikshmëri të një niveli më të lartë për shoqërinë njerëzore. Një vepër e kyer kriminale nga dy e më tepër persona, paraqet një formë të veçantë të veprave penale.

Bashkëpunim quhet kryerja e veprave penale nga dy apo më shumë persona.

Në Kodin Penal të RMV-së, këto forma të kryerjes së veprave penale, gjegjësisht, bashkëpunimi për kryerje të veprave penale, janë përshkruar në kapitullin e tretë, në nenin 22, 23 dhe 24, d.m.th., na paraqitet në tri forma të cilat janë: bashkëkryerja, shtytja dhe ndihma<sup>1</sup>.

Në Kodin Penal të R. së Shqipërisë sipas nenit 26, bashkëpunëtorë për kryerjen e veprës penale quhen: organizatorët, ekzekutorët, shtytësit dhe ndihmësit<sup>2</sup>.

Në Kodin Penal të R. së Kosovës, bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale paraqitet në këto forma: bashkëkryerja, shtytja, ndihma, bashkimi kriminal dhe marrëveshja për të kryer vepër penale<sup>3</sup>.

Që në kohërat e lashta, tek ne shqipëtarët është paraparë në “ligjin-kanunin”, e asaj kohe, e më saktë është quajtur si: “SIMAHORI”- Simahuer është aj, i cilli i ep dorë dorërasit, tuj i ndihmue a në vrasë a në viedhni a në të kryem të çdo mbrapshtije tjetër<sup>4</sup>.

---

<sup>1</sup> Kodi penal i RMV-së

<sup>2</sup> Kodi penal i RSH-së

<sup>3</sup> Kodi penal i R. së Kosovës

<sup>4</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit

Në kohën e Kanunit të Lekë Dukagjinit, në kryerjen e veprave penale ka pasur një emër të veçantë ai i cili ka ndihmuar dhe është quajtur "SIMAHOR".

Fjalë kyçe: Puna ekipore, bashkëpunimi në vrasje, kriminaliteti, kryerja e vepës penale etj

## **ABSTRACT**

To do a perfect job, always teamwork and collaboration with more people has the greatest success. Today in the contemporary world in every job interview, almost always one of the primary questions is whether you are ready and able to adapt to teamwork precisely to achieve the best results and goals.

However, this cooperation and unification of more people to achieve the set goal and "excellent" results, when dealing with crime, poses a risk of a higher level to human society. A criminal offense committed by two or more persons is a special form of criminal offense.

Cooperation is the commission of a criminal offense by two or more persons.

In the Criminal Code of the RMV, these forms of committing criminal offenses, ie cooperation for the commission of criminal offenses, are described in the third chapter, in Articles 22, 23 and 24, i.e., it is presented to us in three forms of which are: co-perpetration, pushing and helping.

In the Criminal Code of the Republic of Albania according to article 26, accomplices for committing a criminal offense are called: organizers, executors, instigators and assistants.

In the Criminal Code of the RMV, cooperation in the commission of a criminal offense is presented in the following forms: co-perpetration, incitement, aiding and abetting, criminal association and agreement to commit a criminal offense.

Since old times, for us Albanians it is foreseen in the "law-canon", of that time, more precisely it is called as; "SIMAHORI- Simahuer is the one who gives his hand to the handmaiden, to help him either in murder or in stealing or in committing any other evil."

At the time of the Kanun of Lekë Dukagjini, the one who helped to commit a criminal offense had a special name and was called "SIMAHOR".

Keywords: Teamwork, co-operation murders, criminality, committing a criminal act, etc.

## **АПСТРАКТ**

За да се постигне совршена работа, секогаш тимската работа и соработката со повеќе луѓе има најголем успех. Денес во современиот свет на секое интервју за работа, речиси секогаш едно од примарните прашања е дали сте подготвени и способни да се прилагодите на тимската работа токму за да ги постигнете најдобрите резултати и цели.

Но, ваквата соработка и обединување на повеќе луѓе за постигнување на целта и „одлични“ резултати, при справувањето со криминалот, претставува ризик од повисоко ниво за човечкото општество. Посебен облик на кривично дело е кривично дело сторено од две или повеќе лица.

Соработка е извршување на кривично дело од две или повеќе лица.

Во Кривичниот законик на РСМ овие облици на извршување на кривични дела, односно соработка за извршување на кривични дела се опишани во третото поглавје, во членовите 22, 23 и 24, односно ни е претставено во три облици на кои се: соизвршителство, поттикнување и помагање.

Во Кривичниот законик на Република Албанија според член 26, соучесници за извршување на кривично дело се нарекуваат: организатори, извршители, поттикнувачи и помошници.

Во Кривичниот законик на РСМ соработката во извршување на кривично дело е претставена во следните облици: соизвршување, поттикнување, помагање, злосторничко здружување и спогодба за извршување на кривично дело.

Уште од поранешните времиња, за нас албанците тоа е предвидено во тогашниот „закон-канон“, поточно се нарекува како: „СИМАХОРИ“- Симахуер е тој што ја дава раката на



извршителот, за да му помогне или во убиство или во кражба или во извршување на кое било друго зло.

Во времето на Канунот на Леке Дукаѓини, тој што помагал да се изврши кривично дело имал посебно име и се викал „СИМАХОР.

Клучни зборови: тимска работа, соисвршители во убиство, криминалитет, извршување на кривично дело итн.

## QËLLIMET E HULUMTIMIT

A është e drejtë që të marrin dënimin e njejtë edhe kryerësi i veprës penale edhe bashkëkryerësi, ky është qëllimi kryesor i këtij hulumtimi dhe punimi i kësaj teze të masterit!

Cilat janë rrethanat rënduese e cilat lehtësuese për nje vendim të drejtë, do të jetë gjithashtu një ndër qëllimet e hulumtimit.

Sot, ku gjyqësia e R. e Maqedonisë së Veriut është ndër titujt kryesor të Lajmeve, portaleve, shohim vendime gjyqësore të ndryshme, pikërisht për dënimin e bashkëkryerësve të veprave penale.

A janë këto vendime të drejta e të bazuara në kodin tonë e në legjislacionin tonë, si dhe bashkëkryerësit e veprave penale a marrin dënim të drejtë apo të padrejtë, do të jetë qëllimi i hulumtimit dhe do të mundohemi që gjatë këtij hulumtimi, me anë të analizimit të detajuar në pjesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore të arrijmë në një përgjigje të caktuar.

Si qëllime të veçanta, gjatë këtij hulumtimi, gjithashtu theks të veçantë do t'u kisha vënë dhe tipareve personale apo vetive dalluese që ka të bëjë me karakterin e tyre, si p.sh. me personalitetin, maturinë, mënyrën e jetesës, përgatitjen profesionale, faktorëve, shoqërorë, social, familjarë etj, të cilat kanë të bëjnë me atë që e shpien një person deri në kryerjen e veprës penale.

## HIPOTEZAT

### **Hipoteza kryesore :**

Veprat penale mund të kryhen nga një person, mirëpo kemi shumë shpesh raste kur kryerja e veprave penale na paraqitet si vepër penale e kryer nga më shumë persona. Nëse më shumë persona, kryejnë vepër penale me pjesëmarrje të tyre në një veprim kundërligjor, çdonjëri prej tyre duhet të dënohet sipas dispozitave ligjore me dënimin e paraparë për atë vepër penale, pra, këtu vjen në shprehje parimi i përcaktueshmërisë së veprës penale sipas dispozitave ligjore.

### **Hipotezat ndihmëse në këtë hulumtim do të ishin:**

-Kryerja e veprave penale nga më shumë persona si dhe format e kryerjes së veprave penale në bashkëpunim, gjegjësisht kryerja e veprave penale nga më shumë persona na paraqitet në disa forma të ndryshme dhe atë si:

#### **1.Bashkëkryerje**

Bashkëkryerja e veprave penale paraqet formën ku, nëse dy ose më shumë persona, duke marrë pjesë në një akt të kryerjes ose me një kontribut tjetër të veçantë për kryerjen e një vepre penale,sëbashku kryejnë një vepër penale dhe në atë rast secili prej tyre do të dënohet me dënimin e paraparë për atë vepër.

#### **2.Shtytje - Nxitje**

Nxitja në kryerjen e veprave penale paraqet formën ku çdo person i cili me qëllim nxit tjetrin që të kryej vepër penale. Nxitësi për vepër që ka nxitur të kryhet, do të dënohet sikur ai vetë ta ketë kryer atë vepër penale.

#### **3.Ndihma**

Ndihma në kryerjen e veprave penale është ajo formë e ndihmës ku çdo person me qëllim ndihmon tjetrin për të kryer një vepër penale. Ndhmësi do të dënohet sikur ai vetë ta ketë kryer atë vepër penale.

Ndihma për kryerjen e një veprë penale na paraqitet në disa forma të veçanta si<sup>5</sup>:

- dhënia e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale,
- vënia në dispozicion e mjeteve kryerësit për kryerjen e veprës penale,
- heqja e pengesave për kryerjen e veprës penale,
- si dhe premtimi paraprak ndaj autorit për fshehjen e veprës penale, mjetin me të cilin është kryer vepra penale, gjurmët e veprës penale ose mjetet e marra me atë vepër penale.

-Gjithashtu, kemi dhe veprat penale të kryera në formë të organizuar. Nga “Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, e vitit 2000 krimi i organizuar përcaktohet si “Grup kriminal i organizuar”, i cili nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohore të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime ose vepra penale serioze, të përcaktuara si të tilla në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitime financiare ose materiale<sup>6</sup>.

Si më e ndijshme e më delikate, na paraqitet kryerja e veprave penale në bashkëpunim apo në bashkëkryerje nga ana e të miturve.

Të mituarit, sipas dispozitave ligjore të RMV-së, ndahen në dy grupe dhe atë në të mituarit e rinj që janë të moshës nga 14 deri në 16 vjeç dhe të miturit e rritur, që janë të moshës nga 16 deri në 18 vjeç. Këtë kategori, e më sakt veprat penale të kryera nga ana e të miturve në bashkëpunim apo në bashkëkryerje gjatë këtij hulumtimi do të trajtohen me theks të veçantë, duke i analizuar dhe gjithë faktorët që shpjen në “formimin e delikuentëve”.

---

<sup>5</sup> Kodi penal i RMV-së, neni 24, paragrafi 2

<sup>6</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, Palermo, 2000

## RËNDËSIA E PUNIMIT

Rëndësia e këtij punimi qëndron në hulumtimin dhe analizimin e më shumë rasteve nga praktika gjyqësore, e me theks të veçantë për denimet që ju janë shqiptuara bashkëkryerësve të veprave penale, në raport me kryerësit e po të njejtës vepër.

Që në kohërat e lashta, ku zbatohesh (aplikohesh), dënimi me vdekje e ku pasojat ishin të një peshe më të madhe, pasoja këto që kishin të bënin me jetë njeriu, ku janë shqiptuar dënime me vdekje, si për kryerësin e veprës penale ashtu edhe për ndihmësin apo bashkëkryerësin, vijmë në një pikë të rëndësishme ku edhe raste konkrete, si për shembull, rasti i “Bufe dhe Bontem”, në Francë<sup>7</sup>, ku njëri ishte kryerës i veprës penale dhe tjetri vetëm shoqërues, që të dy marrin dënim të njejtë dhe atë dënim me vdekje.

A është i drejtë një vendim i tillë?! A duhet marrë të njejtin dënim, ai që kryen veprën penale, si dhe ai që nuk ndërmer veprim personal, por vetëm ndihmon apo e nxit atë?!

Sot, në shtetet e Evropës, përveç Bjellorusisë dhe Rusisë, në tërësi është hequr zbatimi i denimit me vdekje, gjegjësisht është anuluar (abroguar). Mirëpo, aspak nuk është e një rëndësie të vogël edhe shqiptimi i dënimeve të tjera, dënime këto që janë të përcaktuara në Kodin Penal të R. së Maqedonisë së Veriut, ku në praktikën gjyqësore, të njejtin dënim marrin edhe kryerësi i veprës penale, poashtu edhe ndihmësi apo bashkëkryerësin, që një veprim i tillë duhet të shqyrtohet nga ligjvënësit, përsëri me theks të veçantë ndaj bashkëkryerësit të veprës penale.

Nga praktika e hetimit dhe e gjykimit të veprave penale që janë të kryera në bashkëpunim, janë evidentuar një sërë problemesh.

---

<sup>7</sup> Abolicioni, Rober Badenter

Që nga fillimi i procesit, një nga problemet e para na paraqitet edhe mbrojtja e bashkëkryerësve – të pandehurve nga i njëjti avokat. Ligji i procedurës penale i RMV-së, në nenin 64, në përmbajtjen e tij përfshin se, më tepër të akuzuar mundet të kenë mbrojtës të njëjtë, vetëm nëse ajo nuk është në konflikt me interesat e tyre të mbrojtjes<sup>8</sup>. Zakonisht, nga praktika hasim në raste ku të akuzuarit që janë në të njëjtën akuzë, nuk do të thotë se kanë interesa të njëjta.

Duke i analizuar elementet e veprës penale të cilat ndahen në elemente objektive e subjektive e më pas ato objektive ndahen në formale e materiale, mendoj se dispozitat ligjore të vendit tonë kanë nevojë për ndryshime e plotësime.

Sipas të drejtave penale bashkëkohore, dënimi duhet të jetë personal e më pas duhet të jetë njerëzor (human), në fakt, mos të shkaktojë mundim dhe përbuzje të delinkuentit dhe dëmtim të shëndetit të kryerësit e ku dëmi duhet të jetë në proporcion me peshën e asaj veprë penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit.

Qëllimet e dënimit janë të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij/saj dhe të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprës penale<sup>9</sup>. Pikërisht nga këto që u cekën më lartë, dalin qëllimet dhe rëndësia e këtij punimi e që ka të bëjë me dënimet e bashkëkryerësve të veprave penale në praktiken gjyqësore të Gjykatës Themelore në Gostivar.

---

<sup>8</sup> Ligji i procedurës penale i RMV-së, neni 64

<sup>9</sup> Kodi Penal i RMV-së

## KAPITULLI I

### Njohuri të përgjithshme mbi veprat penale të kryera në bashkëpunim

#### 1. Njohuri të përgjithshme mbi institutin e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale

Shumë shpesh na paraqiten rastet ku në kryerjen e një vepre penale për t'ia arritur qëllimit deri në fund, marrin pjesë më shumë persona. Nga rastet që po i hasi në praktikë, nga puna ime si avokate, e që nuk janë aspak në numër të vogël, paraqitet se në raste të tilla ekzistojnë shumë forma të ndryshme të veprimit të përbashkët dhe stadi të ndryshme me anë të kontributit të pjesëmarrësve në kryerjen e veprës penale. Ekzistojnë bashkimet të ndryshme kriminale të cilat kanë strukturën e tyre udhëheqëse, e të organizuar mirë. Ato merren me kriminalitet të cilin e konsiderojnë si një veprimtari me të cilin merren në forme konstante apo të përhershme. Mirëpo, gjithashtu kemi edhe forma tjera me anë të cilave forma veprimtaria e tyre e përbashkët kriminale konsiderohet me intenzitet më të ulët të organizimit. Kjo që u tha ka lidhjen e çastit apo atë lidhjen e momentit ku më shumë persona, në mënyrë krejt rastësisht përfshihen në kryerjen e një vepre penale. Fenomenit të tillë kujdes të i vecnatë i kanë kushtuar edhe teoria e të drejtës penale, e gjithashtu edhe ligji e praktika, raste këto që në kryerjen e një vepre penale marrin pjesë më shumë persona.

Element shumë i rëndësishëm është veprimi i njeriut. E në hulumtimin tonë me rëndësi është veprimet të cilat i marrin bashkëkryesit për të kryer një vepeër penale në bashkëpunim. Vepra penale mund të kryhet me veprim dhe mosveprim, mund të kryhet me dashje apo nga pakujdesia, të mbetet në tentativë etj.

Me termin veprim, në të drejtën penale nënkuptojmë të gjitha sjelljet apo veprimet e njeriut që manifestohen në botën e jashtme dhe të cilat janë të përcaktuara me ligj si vepra penale<sup>10</sup>. Veprimet që paraqiten në mendjen dhe vullnetin e një personi e të cilat burojnë nga brendësija e tij, janë: mendimet, dëshirat, vendimet dhe qëllimet e tij për të kryer vepër kriminale apo

---

<sup>10</sup> Kodi penal i RKS-së

penale. Që të konsiderohen si vepra të kunderligjshme at veprime duhet të shprehen apo manifestohen në botën reale apo në botën e jashtme.

Në të drejtën penale që nje veprim të konsiderohet i rëndesisë së lartë apo ne fjalorin juridik e hasim si e rëndesisë relevante, duhet të vijë në shprehje vullneti ose ai veprim duhet të burojë nga vullneti i tij, dhe i ndërmarrë nga ana e personit të vetëdijshëm. Sipas të drejtës penale nuk sjelljet apo veprimet e ndërmarra apo ato sjellje e veprime që shkaktohen pa vetëdije janë të pandshkueshme, të pandëshkueshme janë edhe ato veprime që kanë ndodhur rastësisht apo nën ndikimin e dhunës ose kanosjes, e të cilat veprime mund të jenë veprimi në gjumë, shembull konkret kur nëna ja zë frymën foshnjës së vetë të posalindur dhe e mbytë, apo personi i cili duke ecur në trotuar për shkak të ngricës rrëshqet dhe me atë veprim i shkakton lëndim tjetrit që është gjendur pranë tij.

Kurse personi që vepron me vetëdije, përkundër vullnetit të tij, në rastin kur nën ndikimin e dhunës apo kanosjes detyrohet të ndërmarrë veprimin e caktuar, p.sh. kur personi A ja drejton armën personit B, që është duke punuar në sportelin e bankës dhe në këtë mënyrë e detyron që t'ia dorëzojë të gjitha të paratë që gjenden në kasafortë. Të rëndësishme janë vetëm ato veprime të cilat i ndermerr njeriut e të cilat veprime i përgjigjen ndonjë veprimi të përcaktuar në figurën ligjore të veprës penale përkatëse. Kjo është në harmoni me parimet e ligjshmërisë së veprës penale. Sipas kodit penal të RMV-së, vepra penale mund të kryhet me veprim ose me mosveprim<sup>11</sup>.

Mënyra se si manifestohet veprimi i kryerjes së veprës penale, kemi dy lloje të veprave penale që i njeh e drejta penale: vepra penale që kryhen me veprim dhe vepra penale që kryhen me mosveprim. Veprat penale që kryhen me veprim janë ato vepra të cilat manifestohen me lëvizje trupore të vullnetshme, (p.sh. marrja e sendit të huaj te vepra penale e vjedhjes, shkrepija me armë te vepra penale e vrasjes etj). Veprat penale të kryera me veprim (delikte komosive), cenojnë normat penalo-juridike, të cilat veprimin e caktuar ndalojnë. Këto norma të cekura quhen norma prohibitive. Veprat penale të kryera me mosveprim (delikte omisive), kryhen me

---

<sup>11</sup> Kodi penal i RMV-së

mos ndërmarrjen e veprimit që ka qenë i detyruar ta ndërmarrë. Një qëndrim i tillë i njeriut gjatë kryerjes së veprës penale në rrethanat e caktuara shprehet si qëndrim pasiv, për shkak të cilit qëndrim shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme. Si vepër penale e kryer me mosveprim është p.sh. mos dhënia e ndihmës mjeksore. Me mosveprim gjatë kryerjes së veprës penale çënohen normat të cilat urdhërojnë apo obligojnë që të ndërmerret veprimi i caktuar. Këto norma ndyshe quhen si norma imperative ose perceptive.

Duke u bazuar në përkufizimet ligjore, veprat penale me mosveprim mund të kryejnë vetëm ata persona që kanë pasur obligim apo detyrë që ti ndërmarrin veprimet e caktuara, sipas ndonjë dispozite ligjore, p.sh., që prindërit të kujdesen, edukojnë dhe ti mbajnë fëmijët e tyre është obligim ligjor që parashihet me anë të dispozitave ligjore të ligjit për familjen dhe nëse ky obligim nuk përmbushet, atëhere kemi të bëjmë me shkelje të detyrimeve familjare gjë që paraqet vepër penale. Veprat penale të kryera me mosveprim mund të ndahen në dy grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë vepra penale **të drejta** të kryera me mosveprim, ndërsa në grupin e dytë na paraqiten veprat penale **jo të drejta** të kryera me mosveprim.

Veprat penale **të drejta** të kryera me mosveprim apo grupi i parë definoohen si lloje të veprave të cilat janë përcaktuar se mund të kryhen vetëm me mosveprim edhe në kodin penal, e si raste konkrete shembull mund të merret mosdhënia e ndihmës personit, jeta e të cilit gjendet në rrezik të drejtpërdrejtë.

Veprat penale **jo të drejta** të kryera me mosveprim apo grupi i dytë definoohen si lloje të veprave të cilat zakonisht kryhen me veprim, mirëpo në disa raste mund të kryhen edhe me mosveprim, e në raste konkrete na paraqiten si vepra penale e vrasjes, zakonisht kryhet me veprim, mirëpo mund të kryhet edhe me mosveprim në rastin kur e nëna me qëllim që ta privojë nga jeta foshnjën e saj, nuk i jep ushqim dhe kështu fëmija vdes. Në këtë rast është fjala për vepër penale me veprim, e cila është kryer me mosveprim.

Zakonisht apo në të shumtën e rasteve në vendin ku është ndërmarrë veprimi i kryerjes, gjegjësisht vendi i kryerjes së veprës penale aty shkatohet edhe pasoja e veprës penale. Në këto raste pa mëdyshje se vend i kryerjes së veprës penale do të konsiderohet vendi ku është



ndërmarrë veprimi dhe ku është shkaktuar pasoja. Mirëpo, kemi raste ku veprimi i kryerjes së veprës penale është ndërmerrë në një vend, kurse pasoja shkaktohet në vendin tjetër, p.sh., personi X nga Shkupi, në bisedë telefonike e ofendon personin Y në Gostivar. Në këtë rast veprimi i kryerjes së veprës penale të fyrjes është ndërmarrë në Shkup, kurse pasoja është shkaktuar në Gostivar. Këto janë të ashtuquajturat vepra penale distancionale.

Përcaktimi i vendit të kryerjes së veprës penale është i rëndësi për këto arsye: prej vendit ku është kryer vepra penale varet se cili ligj penal do të aplikohet, sipas vendit të kryerjes se veprës penale përcaktohet kompetenca territoriale e gjykatave, te disa vepra penale- vendi i kryerjes së veprës penale konsiderohet element konstitutiv, në disa raste- në aspektin e së drejtës penale ndërkombëtare është me rëndësi përcaktimi i vendit të kryerjes së veprës penale kur veprimi i kryerjes është ndërmarrë në një shtet kurse pasoja është shkaktuar në shtetin tjetër<sup>12</sup>.

Lidhur me përcaktimin e vendit të kryerjes së veprave penale distancionale, në shkencën e së drejtës penale njihen tre teori: teoria e veprimit (vendi ku është ndërmarrë veprimi), teoria e pasojës apo suksesit (vendi ku është shkaktuar pasoja) dhe teoria e ubikvitetit (vendi ku është ndërmarrë veprim dhe vendi ku është shkaktuar pasoja). Koha e kryerjes së veprës penale zakonisht menjëherë pas ndërmarrjes së veprimit shkaktohet pasoja e veprës penale. Në raste të tilla, nuk na paraqet problem përcaktueshmëria e kohës së kryerjes së veprës penale në të drjtën penale, sepsen koha e ndërmarrjes së veprimit dhe koha e shkaktuarjes së pasojës përputhen. Mirëpo, në praktikë kemi raste ku ndodh që veprimi të ndërmerret në një kohë, e pasoja të shkaktohet më vonë, p.sh., personi A me qëllim që ta privojë nga jeta personin B shkrep armën në të dhe e plagosë rëndë, dhe përkundër përpjekjeve të mjekëve, personi B vdes në spital pas 1 muaji. Çështja e përcaktimit të kohës së kryerjes së veprës penale, ka rëndësi të posaçme në praktike. Kjo rëndësi ka të bëjë me faktin se prej përcaktueshmëria e kohës së kur është kryer vepra penale varet, do të varet ajo se cili ligj do të aplikohet. Do të aplikot ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur është ndërmarrë veprimi apo do të aplikohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur është shkaktuar pasoja.

---

<sup>12</sup><https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fsites.google.com%2Fsite%2Fjuridikal%2Ffusha-te-se-drejtës%2Fe-drejta-penale>

Bashkëpunimi në të drejtën penale bashkëkohore konsiderohet si institut që rregullohet me pjesën e përgjithshme të kodit penal të shtetit tonë. Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale, paraqet rrezikshmëri të lartë dhe për këtë arsye në Kodin penal të RMV-së, te format e posaçme si forma më të rënda të veprave penale themelore, nëse kryerësi vepron si anëtar i grupit janë paraparë dënime. Pjesëmarrja e dy apo më shumë personave në kryerjen e veprave penale nuk paraqet element të mjaftueshme, por duhet të ekzistojë edhe elemente të tjera e të cilat janë lidhja objektive dhe subjektive midis bashkëpunuesve. Është e rëndësishme kyçe kjo sepse kemi shumë shpesh situara kur dy ose më shumë persona kryejnë veprën penale të vjedhjes , e ku veprimtaria e tyre ka qenë absolutisht e pavarur. Kështu, p.sh. një e thyen xhamin e një shitoreje dhe me qëllim të përvetësimit i merr disa produkte, e në ndërkohë pranë kalon edhe një person tjetër, i cili po ashtu me qëllim të përvetësimit, i merr disa produkte të tjera. Lidhja objektive te bashkëpunimi qëndron në atë se secili bashkëpunues veprimin të cilin e ndermerr duhet të kontribuon në kryerjen e veprës penale, e qëllim i saj është që shkaktohet pasoja të cilën e kanë caktuar e kjo arrihet si rezultat i veprimeve të përbashkët nga bashkëpunuesit, ndërsa lidhja subjektive ka të bëjë me faktin e vetëdijes apo kur të gjithë bashkëpunuesit që të veprojnë në mënyra të ndryshme me qëllim të përbashkët, duhet të jenë të vetëdijshëm, me ç'rast njohja mes tyre nuk është aspak e domosdoshme, për tu konsideruar bashkëkryerës të veprës penale.

## **2. Kuptimi i veprave penale të kryera në bashkëpunim**

Vepra penale mund të kryhet nga një person apo disa persona dhe kur vepra kryhet nga disa persona, atehere quhet bashkëpunim.<sup>13</sup>

### **Ekzistojne tre lloje të bashkpunimit:**

1. Bashkëkryerja;
2. Shtytja (nxitja);

---

<sup>13</sup> I. Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2005,

3.Ndihma;

**BASHKËKRYERJA**- Ekziston kur dy e më shumë persona kryejnë vepër penale. Shembull konkret mund të merret rasti te vepra penale e vrasjes kur dy apo më shumë persona shtiejnë me arme ndaj një personi. Sipas ligjit penal, secili bashkëkryes do të pergjigjet penalisht brenda kufijve të dashjes apo pakujdesisë.

**SHTYTJA (NXITJA)** - Në ligjin penal është paraparë që : “Kush e shtyt tjetrin me dashje të kryej vepër penale, denohet sikur ta kishte kryer vetë”.

Shtytja apo nxitja mund të kryhet ne rastet kur ndaj një personi i cili aspak nuk e ka ndërmend që të kryej vepër penale, mirëpo ai person me veprime të caktuara nga një person tjetër (shtytësi-nxitësi) ndikohet që të kryej vepër penale.

Forma e tjetër e shtytjes apo nxitjes na paraqitet rasti kur ai një person nuk ka vendosur që definitivisht të kryej vepër penale, mirëpo ai ndikohet a një person tjetër (shtytësi-nxitësi) që të vendos qe ta kryej veprën penale.

Në bazë të Ligjit penal nuk janë të përcaktuara mënyrat e shtytjes si dhe nuk janë të përcaktuaramjetet e shtytjes.

Si veprime të shtytjes mund të konsiderohen p.sh. veprimet me te cilat bindet tjetri, i premtohet dhënia e dhuratës, lutja, kur ai person kanoset, dhënia e keshillave ati personi, etj.

Shtytjen mund ta bëjnë më shumë se një persona. Kur e bëjnë shumë perona, atëhere ajo quhet bashkështytje. Shtytësi personin të cilin e shtyt duhet ta njoh e që më pas ai të kryej veprën penale. Shtytja mund të kryhet vetëm me dashje. Rastet kur shtytësi lirohet nga përgjegjësjia apo nuk ndëshkohen, janë ato raste kur shtytja është kryhet nga pakujdesia. Shtytësi dënohet për çdo vepër penale dh ai dënohet sikur ta kishte kryer vetë veprën penale.<sup>14</sup>

---

<sup>14</sup> Petar Novoselac, Opći dio kaznenog prava, Zagreb, 2007

**NDIHMA-** Ndihma na paraqet ato veprime të një personi me të cilat ndihmohet një person tjetër që të kryhet vepra penale.

Ndihma llogaritet se mund të kryhet në ato raste vetëm pasi që personi tjetër të ketë vendosur ta kryej atë veprën penale.

Ekzistojnë dy lloje ndihmash: ajo fizike dhe psikike.

Si ndihmë fizike konsiderohet kur një person ia jep apo ia ven në disponim personit tjetër mjetet për të kryer veprën penale, apo kur ia menjanon pengesat për kryerjen e veprës, ndërsa ndihma psikike konsiderohet dhënia e këshillave, udhëzimeve si dhe premtimi se do të fshihet vepra penale, kryesi i saj, gjurmët, apo sendet e fituara nga ajo veper<sup>15</sup>.

Për dallim nga shtytja, ndihma ndaj një personi mund të kryhet në dy mënyra: mënyra e parë është ajo me veprim dhe mënyra e dytë është ajo me mosveprim.

Sipas legjislacionit tonë, ndihmesi mund të denohet deri në  $\frac{3}{4}$  e maksimumit të denimit të paraparë. Format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale janë përcaktuar në dispozitat e neneve 22, 23, dhe 24 të Kodit Penal të RMV-së si bashkëkryerje, shtytje dhe ndihmë. Bashkëpunimi përfshin individë ose grupe që punojnë së bashku për arritjen e qëllimeve të tyre individuale ose kolektive. Në formën e tij më të thjeshtë, bashkëpunimi mund të përfshijë vetëm dy persona që punojnë së bashku drejt një qëllimi të përbashkët. Dy studentë të kolegjit që punojnë së bashku për të përfunduar një eksperiment laboratorik, ose dy të rinj ndërqytetarë që punojnë së bashku për të mbrojtur 'terrenin' e tyre nga dhunimi nga të huajt janë shembuj. Në këto raste inkurajohet solidariteti ndërmjet bashkëpunëtorëve dhe ata ndajnë së bashku shpërblimin e bashkëpunimit të tyre. Përsëri në nivelin e ndërveprimeve me dy persona, qëllimet drejt të cilave punojnë palët e bashkëpunimit mund të jenë në përputhje

---

<sup>15</sup><https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fsites.google.com%2Fsite%2Fjuridikal%2Fusha-te-se-drejt%2F-drejta-penale>

me njëra-tjetrën, por ato mund të mos jenë identike ose të përbashkëta. Nga përvoja e kolegjit përsëri, studenti dhe profesori mund të bashkëpunojnë drejt zotërimit të disiplinës së profesorit nga studenti, por studenti mund të jetë duke punuar për të bërë një notë të mirë ndërsa profesori po punon për të krijuar ose përforcuar reputacionin e tij/saj si mësues i mirë. Nëse disa nga shpërblimet e tyre ndahen, disa janë gjithashtu individuale, por të arritshme vetëm me përpjekje të përbashkët. Palët bashkëpunuese në këtë rast mund të jenë ose neutrale ose të sjellshme ndaj njëra-tjetrës, por marrëdhënia e tyre nuk ka gjasa të ketë solidaritet të qëndrueshëm.

Njeriu nuk mund të shoqërohet pa bashkëpunuar, pa punuar së bashku në ndjekje të interesave të përbashkëta. Mund të ndahet në pesë lloje kryesore.

#### 1. Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë:

Ato aktivitete në të cilat njerëzit bëjnë si gjërat së bashku, të luajnë së bashku, të adhurojnë së bashku, të punojnë së bashku në një mori mënyrash. Karakteri thelbësor është që njerëzit i bëjnë në shoqëri, gjërat që mund t'i bëjnë edhe veçmas ose të veçuar. Ata i bëjnë së bashku sepse kjo sjell kënaqësi sociale.<sup>16</sup>

#### 2. Bashkëpunimi indirekt:

Janë ato aktivitete në të cilat njerëzit definitivisht nuk i pëlqejnë detyrat drejt një qëllimi të vetëm. Këtu prezantohet parimi i famshëm i 'ndarjes së punës', një parim që është i ngulitur në natyrën shoqërore që zbulohet kudo ku njerëzit kombinojnë dallimet e tyre për kënaqësi reciproke ose për një qëllim të përbashkët.<sup>17</sup>

#### 3. Bashkëpunimi Primar:

Gjendet në grupet parësore si familja, lagjja, miqtë e kështu me radhë. Këtu ka një fund identiteti. Shpërblimet për të cilat të gjithë punojnë ndahen ose synohen të ndahen, me çdo

---

<sup>16</sup> Kohn, Alfie (1992). *No Contest: The Case Against Competition*. Houghton Mifflin Harcourt. p. 19. [ISBN 978-0-395-63125-6](https://www.amazon.com/No-Contest-Case-Against-Competition/dp/0395631256).

<sup>17</sup> Kohn, Alfie (1992). *No Contest: The Case Against Competition*. Houghton Mifflin Harcourt. p. 19. [ISBN 978-0-395-63125-6](https://www.amazon.com/No-Contest-Case-Against-Competition/dp/0395631256).

anëtar tjetër në grup. Mjetet dhe qëllimet bëhen një, sepse vetë bashkëpunimi është një vlerë shumë e çmuar.

#### 4. Bashkëpunimi dytësor:

Është tipar karakteristik i shoqërisë moderne të qytetëruar dhe gjendet kryesisht në grupet shoqërore. Është shumë i formalizuar dhe i specializuar. Secili kryen detyrën e tij apo saj dhe në këtë mënyrë ndihmon të tjerët të kryejnë detyrat e tyre, në mënyrë që ai ose ajo të shijojë veçmas frytet e bashkëpunimit të tij apo saj.

#### 5. Bashkëpunimi terciar:

Mund të gjendet midis 2 ose më shumë partive politike, kastave, fiseve, grupeve fetare etj. Shpesh quhet akomodim. Të dy grupet mund të bashkëpunojnë dhe të punojnë së bashku për qëllime antagoniste.<sup>18</sup>

Bashkëpunimi është i rëndësishëm në jetën e një individi që njeriu e ka të vështirë të mbijetojë pa të. C.H. Cooley thotë se bashkëpunimi lind vetëm kur burrat kuptojnë se kanë një interes të përbashkët. Ata kanë një temë, inteligjencë dhe vetëkontroll të mjaftueshëm, për ta kërkuar këtë interes nëpërmjet veprimit të bashkuar.

### 3. Historiku i veprave penale të kryera në bashkëpunim

Organizata kriminale konsiderohet si forma e intenzitetit më të lartë të bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona. Kjo organizatë dallohet nga stadiumet e veçantë të sa i përket organizimit të saj, e që këtu përfshihet edhe strukturimi, e poashtu edhe kohëzgjatjes së bashku me qëndrueshmërisë e saj, që kanë synim e qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, me anë të së cilës do të realitojnë përfitime materiale por edhe jomateriale. Organizata terroriste është një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë

---

<sup>18</sup> Wedekind, Claus; Milinski, Manfred (5 May 2000). "[Cooperation Through Image Scoring in Humans](#)". *Science*. **288** (5467):850–852. [Bibcode:2000Sci...288..850W](#). [doi:10.1126/science.288.5467.850](#). [ISSN 0036-8075](#). [PMID 10797005](#)

nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste<sup>19</sup>. Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale, të parashikuara në krerët V, VI dhe VII të pjesës së posaçme të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë<sup>20</sup>. Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale dhe ky grup i strukturuar kriminal për kryerjen e një veprave penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar<sup>21</sup>. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë ose të dispozitave të tjera penale të veçanta<sup>22</sup>. Anëtarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale, të kryera prej tyre, në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale<sup>23</sup>. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose i grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtimin nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë, që gjykohet vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejt ose jo prej tyre, si dhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuar kriminale<sup>24</sup>. Vepra penale ka si qëllim goditjen e atyre sjelljeve njerëzore të cilat prekin të mira që kanë një vlerë themelore për të gjithë shoqërinë. Pikërisht për të kuptuar vlerën juridike të fakteve të parashikuara në ligj si vepra penale në lidhje me të mirat juridike të cilat ligjvënësi synon të mbrojë, është e nevojshme ndarja dhe analizimi shkencor i të gjithë elementëve përbërës të veprës penale. Gjatë studimeve shkencore mbi

---

<sup>19</sup> <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fidmalbania.org%2Fwp-content%2Fuploads%2F2021%2F11%2FPREVEX-Policy-paper-Albania-ALB-1.pdf>

<sup>20</sup> Pjesa e posaçme e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

<sup>21</sup> Pjesa e posaçme e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

<sup>22</sup> Po aty

<sup>23</sup> po aty

<sup>24</sup> po aty

institutet themelore që karakterizojnë kodet penale, si tentativa, përgjegjësia e tentativës, pakujdesia, bashkëpunimi, bashkërealizimi i veprave penale, mbrojtja e nevojshme, vepra penale e cilësuar nga rrethana lehtësuese apo rënduese etj; vihet re aplikimi i vazhdueshëm i një terminologjie e cila përdoret nga pjesa më e madhe e manualëve dhe komenteve të së drejtës penale të Italisë, Gjermanisë, Spanjës, Turqisë dhe vendeve të Amerikës Latine, më saktësisht, pjesëtarët e doktrinës së këtyre shteteve të cilët përbëjnë pjesën dërmuese të doktrinës botërore rreth “teorisë së përgjithshme të së drejtës penale”, e cila tashmë është pjesë e kulturës ndërkombëtare edhe të Shqipërisë dhe vendeve tjera të Ballkanit, përdorin shprehjen “mënyrat e shfaqjes së veprës penale”.<sup>25</sup>

Terminologjia në fjalë shpreh një koncept të përgjithshëm, që synon të mbledh të gjitha ato raste në të cilat vepra penale, përveç strukturës së saj elementare, shfaq edhe disa elemente të tjera të cilat e bëjnë të ndryshojë nga prototipi. Këtij modeli klasik të realizimit të veprës penale (i cili identifikon veprën penale të konsumuar në mënyrë të thjeshtë, monosubjektive), i kundërvihen disa mënyra (forma) alternative me anë të cilave vepra penale mund të shfaqet në mënyrë konkrete<sup>26</sup>. Mund të ndodhë që vepra penale të paraqitet e porealizuar, sepse nuk realizohet prekja e të mirës juridike drejt së cilës sjellja ishte drejtuar (p.sh X qëllon me armë në drejtim të Y, por gabon shënjestrën dhe gjuajtja shkon bosh).

Nuk ka dyshim se, një vepër penale e mbetur në tentativë përbën një fakt që nga ana e fenomenologjisë është krejtësisht ndryshe nga fakti i realizuar, e për të ndëshkuar atë që tenton, duhet që dispozitës që parashikon një vepër penale t’i shtohet në mënyrë normative tipiciteti, me anë të një dispozite e cila parashikon tentativën dhe si rrjedhim, në rastin e vrasjes se mbetur në tentativë, do të aplikohet neni 123 (vrasja) në lidhje me neni 19 (tentativa) të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>27</sup>. Pra, kemi të bëjmë me një dukuri ku duhet të bëhet integrimi i dispozitave. Gjithashtu, vepra penale mund të jetë rezultat i bashkëpunimit të disa njerëzve, vullnetet e të cilëve konvergojnë në realizimin e një pasoje të

---

<sup>25</sup> Për herë të parë shprehja: “mënyrat e shfaqjes së veprës penale”, në fjalë është përdorur rreth 1910 në Gjermani nga Beling dhe shprehja ishte “erscheinungsformen”. Ferrando MANTOVANI, *Diritto penale*, Padova, 2007.

<sup>26</sup> Carlo FIORE – Stefano FIORE, *Diritto penale*, Botimi i III, Milano 2008

<sup>27</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut



dëmshme për të mirën juridike, p.sh.: A, B dhe C nisen për të bërë një vjedhje, A futet në banesën e marrë në shënjestër, B bën roje poshtë banesës për të parë mos vijnë pronarët e shtëpisë, C është gati me makinën e ndezur për tu nisur menjëherë pas vjedhjes<sup>28</sup>.

Dispozita e bashkëpunimit është tipike. Bashkëpunimi vjen në shprehje apo mënyra se si një bashkëpunim llogaritet bashkëkyerje në veprat penale janë të përcaktuara e parashikuara nga Kodi penal. P.sh. sipas të Kodit penal të RMV-së, bashkëpunohet apo bashkëpunor llogaritet me anë të bashkëkryesjes të veprës penale, me anë të shtytjes apo nxitjes në realizimin e një veprës penale dhe me anë të dhënies ndihmë për të realizuar një veprë penale. Subjekti i cili është në dijeni rreth përgaditjes së realizimit të një veprës penale, nuk mund të quhet bashkëpunëtor kur i njëjti nuk e kallëzon këtë të fundit përpara organeve kompetente përpara se të ndodhë pasoja. Në këtë rast, subjekti në fjalë nuk mund të cilësohet bashkëpunëtor, por mund të thirret për gjykim pasi vepra të cilën e ka bërë mund të cilësohet si veprë e moskallëzimit të përgaditjes së veprës penale, të parashikuar në nenin 363 të Kodit Penal të RMV-së.

Në R. e Shqipërisë tipiciteti shtrihet në rastet e realizimit sipas nenit 26 të Kodit Penal. Sipas Kodit Penal të R. së Shqipërisë bashkëpunëtorët janë: “Bashkëpunëtorë për kryerjen e veprës penale quhen: organizatorët, ekzekutorët, shtytësit dhe ndihmësit<sup>29</sup>. Organizatorë quhen ata persona që organizojnë dhe drejtojnë veprimtarinë për kryerjen e veprës penale. Ekzekutorë janë personat që kryejnë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale. Shtytës quhen personat që nxisin bashkëpunëtorët e tjerë për kryerjen e veprës penale. Ndihmës quhen personat që me këshilla, udhëzime, dhënie mjetesh, largim të pengesave, dhënie të premtimit për fshehjen e bashkëpunëtorëve, të gjurmëve apo të sendeve që rrjedhin nga vepra penale, ndihmojnë për kryerjen e saj.”<sup>30</sup> Neni 300 i Kodit Penal të R. së Shqipërisë i definuar si Moskallëzimi i krimit:“ Moskallëzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është

---

<sup>28</sup> <https://www.diritto.it/vezhgim-mbi-kategorine-dogmatike-menytrat-e-shfaqes-se-vepres-penale/>

<sup>29</sup> Kodi Penal i R. Së Shqipërisë

<sup>30</sup> Po aty.

kryer, dënohet me gjobë ose me vetëm të një pjese të veprës penale”<sup>31</sup>, kurse në rastin e dytë tipiciteti shtrihet edhe te bashkëpunëtorët në veprën penale. Është e qartë se në rastin e tentativës, në qoftë se kjo figurë nuk do të ishte e parashikuar në ligj, me mosrealizimin e pasojës apo të një pjese të veprimit, duhet të përjashtohet përgjegjësia penale pasi fakti nuk mund të quhet tipik. Ndëshkimi i një krimi në tentativë mund të bëhet vetëm në prezencë të një dispozite që parashikon tentativën dhe që ka si funksion shtrirjen e tipicitetit dhe rasteve në fjalë.

Të njëjtin funksion kanë edhe dispozitat mbi bashkëpunimin e parashikuar në nenet 22, 23, 24 të Kodit penal të R. së Maqedonisë së Veriut si dhe në nenet 25, 26, 27 të Kodit penal të R. së Shqipërisë. Kur vepra kryhet nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokime ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër, paramendimi, lidhjet me viktimën etj, rrethana këto që konsiderohen nga ligji me vlerë për të cilësuar veprën penale si më të lehtë apo më të rëndë<sup>32</sup>. Gjykata do ta dënojë kryerësin e veprës në kufijtë e përcaktuar me ligj për atë vepër, duke pasur parasysh përgjegjësinë penale të kryerësit, peshën e veprës dhe qëllimet e dënimit. Gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i vogël ose më i madh (rrethanat lehtësuese dhe rënduese). Në bazë të këtyre rrethanave lehtësuese apo rënduese, ndryshon edhe masa e dënimit që i aplikohet të pandehurit.<sup>33</sup>

Megjithatë, nuk duhet shkaktuar konfuzion me veprën penale të thjeshtë. Vepra penale e thjeshtë është perfekt në qoftëse paraqet të gjitha elementet thelbësor të saj. Në përfundim, duket e qartë se institutet e veprës penale të cilësuar nga rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe të bashkërealizimit të veprave penale, nuk mund të futen në konceptin e “mënyrave të shfaqjes së veprës penale”.<sup>34</sup>

---

<sup>31</sup> Po aty

<sup>32</sup> <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.diritto.it%2Fvezhgim-mbi-kategorine-dogmatike-menyra-e-shfaqes-se-vepres-penale%2F>

<sup>33</sup> Kodi Penal i RMV-së,

<sup>34</sup> Ismet ELEZI – Skënder KAÇUPI – Maksim HAXHIA, Koment i kodit penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2006. Bazuar mbi nenin 48 të Kodit penal mbi rrethanat lehtësuese dhe nenin 50 të Kodit penal mbi rrethanat rënduese

E drejta penale na paraqitet si degë e të drejtës pozitive juridike dhe si degë e shkencës juridike. E drejta penale në kuptimin e të drejtës pozitive është sistem i të drejtave dhe rregullave ligjore me të cilin përcaktohen veprat penale dhe sanksionet penale si dhe kushtet për zbatimin e tyre ndaj kryerësve të veprave penale e që për qëllim ka mbrojtjen e të mirave materiale të vlerave më të rëndësishme të shoqërisë. Një definicion i atillë sipas të cilit e drejta penale është sistem i të gjitha dispozitave ligjore me të cilat një shtet i rregullon dhe përcakton sjelljet që konsiderohen vepra penale, cilat dënime dhe sanksione të tjera penale dhe, në çfarë kushtesh mund të zbatohen ndaj kryerësve të tyre. Nga këto definicione arrijmë në atë se nocioni i të drejtës penale përmban dy elemente: atë formal dhe material. Elementi material përkufizohet si përmbajtje e të drejtës penale të cilën e përbëjnë përkufizimi i veprës penale, përgjegjësisë penale dhe sanksionit penal, me qëllim të realizimit të mbrojtjes – funksionit garantues, ndërsa elementi formal na pasqyron se vepra penale si dhe sanksioni penal, bashkë me kushtin për zbatimin e tyre mund të definojnë vetëm me ligj, nga ku arrijmë në përfundim se e drejta penale është e drejtë ligjore. Pasi që rregullimi juridik është i definuar me një numër të madh ligjesh që me tërësinë e tyre e përbëjnë legjislacionin e një shteti, dhe se edhe e drejta penale si e drejtë ligjore mund të vështrohet si degë e legjislacionit, respektivisht si degë e të drejtës pozitive të një shteti. Karakteristika materiale e të drejtës penale është e përbërë nga funksioni i tij i mbrojtjes së të mirave shoqërore dhe e vlerave më të rëndësishme të shtetit të caktuar.

Ajo mbrojtje realizohet duke normuar, duke shqiptuar dhe duke i ekzekutuar sanksionet që kanë karakter detyrimi, që zbatohen ndaj kryerësve të veprave penale me të cilat lëndohet ose rrezikohen vlerat e mbrojtura. E drejta penale i shpall disa sjellje të njerëzve si vepra penale, duke paraparë për kryerësit e tyre llojin e caktuar të masës së Dënimit ose sanksionit tjetër penal. Nga kjo del qëllimi i kësaj dege të drejtësisë. Dhe se në të vërtetë përbëhet nga ndikimi në sjelljet njerëzore, duke i orientuar se çka është e palejueshme dhe e ndaluar të veprohet dhe çka jo, që do të thotë se ndikon që njerëzit të sillen në harmoni me ligjet dhe rregullat juridike. Sipas kësaj, qëllimi i të drejtës penale nuk është vetëm në zbatimin e Dënimit ndaj të padëgjueshmëve. Edhe përkundër këtij definicioni materialo-formal të nocionit të së drejtës penale, në teorinë e të drejtës penale, na paraqiten definicione të njëanshme formale ose materiale. Definicionet formale e definojnë të drejtën penale si tërësi ligjesh ose norma penale

juridike në bazë të së cilave organet e caktuara shtetërore – gjykatat i shqiptojnë dhe i zbatojnë sanksionet penale ndaj kryerësve të veprave të ndaluara. Definicionet materiale megjithatë bazohen në atë se, e drejta penale është degë e drejtësisë me të cilën mbrohen interesat e caktuara, respektivisht të mirat materiale ose vlerat tjera shoqërore. Vepra penale është vepër e rrezikshme shoqërore të cilën rendi juridik e ndalon me kërcënim të aplikimit të sanksioneve penale. Ajo është rezultat i sjelljes të njeriut, kështu që mund të caktohet si sjellje e njeriut me të cilën shkelen dispozitat juridike dhe shkaktohen pasoja të dëmshme për shoqërinë, për çka edhe reagohet me aplikimin e sanksioneve penale. Si sjellje e njeriut, si akt i njeriut të caktuar, kjo bart karakteristika të vetë personalitetit: kushteve të tij të jetës, konfliktit me vetveten, konfliktit me individë të tjerë, grupet shoqërore dhe shoqërinë në tërësi. Vepra penale është akt negativ i njeriut dhe i dëmshëm për shoqërinë. Ajo më së shpeshti paraqitet si rezultat i konflikteve ndërmjet individëve dhe interesave të tyre, individëve dhe shoqërisë, si mospajtim ndërmjet dëshirave, nevojave dhe mundësisë për përmbushjen e tyre, si rezultat i ndonjë tronditjeje ose si dalje nga kriza, përkatësisht si zgjidhje negative e ndonjë situatë konflikti ose situatë stresi<sup>35</sup>. Ajo është më së shpeshti akt i vetëdijshëm dhe i vullnetshëm, por mund të jetë edhe akt i pamatur, si dhe akt i projektimit të imagjinatës së sëmurë dhe halucinacionit, përkatësisht rezultat i sëmundjes ose çrregullimit shpirtëror. Vepra penale nuk është akt i njeriut, përkatësisht prodhim i njeriut, por njëkohësisht është edhe dukuri e shoqërisë. Kjo nuk është vetëm akt i rastësishëm dhe i izoluar por akt që përsëritet dhe e bën dukurinë, rrënjët e së cilës janë në kushtet shoqërore të njeriut. Jashtë shoqërisë njerëzore nuk ka vepër. Ajo është dukuri negative e shoqërisë, ngase me këtë akt sulmohen vlerat shoqërore dhe njerëzore dhe rrezikohet ekzistenca e shoqërisë si bashkësi njerëzish. Vepra penale si dukuri shoqërore lidhet me shoqërinë e klasave, sepse me krijimin e shoqërisë klasore, vepra penale si veprimtari kundër shoqërore bëhet dukuri ligjvënëse e kësaj shoqërie, e pandarë nga ajo dhe shoqëruet i përhershëm i saj<sup>36</sup>. Secila vepër me të cilën cenohet dhe rrezikohet pasuria e mbrojtur individuale ose shoqërore, ose vlerat e rëndësisë më të madhe, është vepër e rrezikshme shoqërore. Rreziku shoqëror realizohet duke shkaktuar pasoja në objekt të veprimit të ndërmarrë me vepër njerëzore, ai është përfshirë në efektet e veprimit dhe pasojës dhe bën

<sup>35</sup> Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006, f. 66

<sup>36</sup> Të drejtën penale si degë e të drejtës pozitive juridike në Kosovë e përbën Kodi i përkohshëm penal i RMV-s.

përmbajtjen sociale të veprës penale. Praktikisht, përmes rrezikut shoqëror paraqitet përmbajtja me vlerë të veprës së kryer penale. Ky është element material i veprës penale i cili mbështetet në sjellje reale të kryesit të veprës i cili tregon raportin në mes veprës së ndërmarrë dhe pasojës së realizuar. Pa ekzistimin e rrezikut shoqëror, nuk ka vepër penale. Do të thotë se vepra penale mund të ekzistojë vetëm nëse ajo është vepër e rrezikshme për shoqërinë. Ky element i përgjithshëm i nocionit të veprës penale nuk është i përcaktuar në ligjin e përkohshëm të Kosovës, por mund të themi se nuk ka vepër penale e cila nuk është në të njëjtën kohë e rrezikshme për shoqërinë sepse është e drejtuar kah lëndimi ose kërcënimi i lirive personale dhe të drejtave të njeriut, të drejtave tjera dhe vlerave shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutë, me të drejtën kombëtare, gjegjësisht rendin juridik. Sipas mendimit tonë, rreziku shoqëror është element i pavarur<sup>37</sup>. Ajo nuk është përbërë në elementin e kundërligjshmërisë, por në vepër penale, si akt material në botën e jashtme. Rreziku shoqëror nuk është kategori abstrakte e cila është e përhershme dhe nuk është e ndryshueshme. Përkundrazi, ajo është dukuri shoqërore reale dhe si e tillë historike dhe e kushtëzuar në mënyrë klasore<sup>38</sup>. Do të thotë se, ajo është kategori e ndryshueshme varësisht nga kushtet konkrete të jetës së bashkësisë së caktuar shoqërore. Kështu që, veprat të cilat kanë qenë të rrezikshme për shoqërinë në një epokë, në tjetrën nuk janë. Madje, edhe në të njëjtën shoqëri, rreziku shoqëror ndryshon në varësi prej zhvillimit të kësaj shoqërie prej etape në etapë. Kështu, në një etapë, disa vepra mund të jenë të rrezikshme për shoqërinë dhe anasjelltas. Prej kësaj del se, vepër e rrezikshme shoqërore është vetëm ajo vepër e cila është e rrezikshme për shoqëri të caktuar, në kohë të caktuar. Veprat e rrezikshme shoqërore duhet të dallohen prej veprës së rrezikshme. Do të thotë se, në shoqëri ekziston një varg i tërë i veprave të cilat janë të rrezikshme për sigurinë e njerëzve dhe të pasurisë dhe sipas kësaj të dëmshme por, të cilat nuk konsiderohen si vepra të rrezikshme shoqërore se janë në të njëjtën kohë edhe të dobishme, kështu që, dobia shoqërore nga kryerja e këtyre veprave është shumë ma e madhe se rrezikshmëria dhe dëmi i tyre. Por, çdo vepër e rrezikshme shoqërore nuk është në të njëjtën kohë edhe vepër penale. Për të qenë vepër e rrezikshme shoqërore, vepra penale duhet të jetë

---

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> I. Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2010, f. 230

e paraparë në ligj si vepër penale, dhe nëse është caktuar për kryesin e kësaj veprë sanksioni penal. Prej kësaj rrjedh se, nuk është çdo vepër e rrezikshme shoqërore vepër penale, dhe se çdo vepër penale nuk është vepër e rrezikshme shoqërore. Vepra penale e cila humb karakterin e veprës së rrezikshme shoqërore, pushon të jetë vepër penale. Nëse vepra e tillë mbetet inkriminuese në ligj, ajo ka vetëm karakterin formal-juridik të veprës penale. Rreziku i përgjithshëm shoqëror i veprës është rreziku të cilin e posedon një vepër penale në raport me veprën tjetër penale si për shembull spiunazhi, hajnia, falsifikimi i të hollave etj. Veprat penale kanë rrezik të ndryshëm për shoqërinë, duke marrë parasysh se janë të drejtuara në të mirat e vlerave të ndryshme për bashkësinë shoqërore. Sipas rrezikut të përgjithshëm shoqëror, ligjdhënësi e përcakton llojin dhe masën e dënimit për secilën vepër penale në pjesën e posaçme të ligjit penal<sup>39</sup>. Domethënë, atë e përcakton ligjdhënësi në bazë të vlerësimit abstrakt të rëndësisë së objektit të mbrojtjes dhe vëllimit dhe intensitetit të mundshëm të pasojës. Rreziku i veçantë shoqëror ekziston në format konkrete të paraqitjes së veprës së njëjtë penale. Rrezikun e veçantë shoqëror e përcakton gjykata në secilin rast konkret, në bazë të pasojave reale dhe të shkaktuara në mënyrë të drejtpërdrejtë. Rëndësia e rrezikut të veçantë shoqëror pasqyrohet në atë që ai e tregon në diferencat të cilat ekzistojnë në mes të më shumë veprave të kryera të kualifikimit të njëjtë (gjegjësisht, llojit të njëjtë si për shemb: vrasje, hajni ose përvetësim). Rreziku i veçantë shoqëror është i rëndësishëm për peshimin (matjen) e dënimit të vetëm në raste të jashtëzakonshme për ekzistimin e veprës penale.

#### **4. LLOJET E BASHKËPUNËTORËVE**

Ekzistojnë tre lloje të bashkëpunorëve: bashkëkryerësit, shtytësit, spo nxitësit dhe ndihmësit. Këto tre lloje të bashkëpunorëve i parasheh legjislacioni i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Do të fillojmë nga ajo se çka paraqet një veper penale e kështu në këtë formë të kuptojmë më mirë rolin e këtyre bashkëpunorëve në kryerjen e veprave penale.

Përcaktimi i kuptimit të veprës penale është i rëndësishëm kryesorë të shkencës së të drejtës penale dhe të legjislacionit penal. Do të thotë, përcaktimi i nocionit të veprës penale, i

---

<sup>39</sup> . Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2010, f. 230

përgjegjësisë penale dhe i sanksioneve penale përbëjnë tre çështje kryesore të cilat i shqyrton e drejta penale. Kur ligjvënësi parashikon një fakt si vepër penale, ka për qëllim goditjen e atyre sjelljeve njerëzore të cilat prekin të mira që kanë një vlerë themelore për të gjithë shoqërinë. Bëhet fjalë për të mira juridike, të cilat mund të jenë të drejta personale të individit, por edhe interesa të tij apo të shoqërisë<sup>40</sup>. Me vepër penale do të kuptojmë atë sjellje njerëzore në aspektin formal e cila sjellje me ligj është sanksionuar si vepër penale. Sipas këtij përkufizimi, nuk shqyrtohet se vepra penale është vepër penale kundër moralit dhe shoqërisë, por vetëm nëse ajo është e kundërligjshme. Një përkufizim i tillë nuk parashikon se për cilat shkaqe kjo sjellje konsiderohet vepër penale, por e lidh vetëm me atë që kjo sjellje duhet të jetë e kundërligjshme. Përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore ligjvënësi e bën në bazë të kushteve objektive të shoqërisë. Vlerësimi, nëse një veprim apo mosveprim paraqet rrezikshmëri shoqërore, bëhet duke u nisur nga interesat e kësaj shoqërie. Nga këto nocione të veprës penale vihet re se kuptimi formal e shpjegon faktin vetëm në aspektin juridikë formal. Kurse nocioni material, jep përgjigje se për çfarë shkaqesh një vepër konsiderohet vepër penale, arsyet se përse ai veprim është i dëmshëm<sup>41</sup>. Të marra në mënyrë të shkëputur, këto dy teori nuk e përcaktojnë në mënyrë adekuate dhe në tërësi nocionin e veprës penale. Si konkluzion, mund të thuhet se vepra penale përkufizohet vetëm nëse merren parasysh elementët formal dhe material të saj. Një veprim ose mosveprim si element përbërës i veprës penale, që të jetë i kundërligjshëm duhet të vijë në kundërshtim me normat dhe rendin juridik, pra duhet të jetë në kundërshtim me ligjin. Kundërligjshmëria paraqet bazën juridike për përcaktimin e veprës penale<sup>42</sup>. Në asnjë rast veprimi ose mosveprimi, nuk mund të përbëjë vepër penale pa u parashikuar shprehimisht në ligj një gjë e tillë.

#### 4.1 Bashkëkryerësi

Bashkëkryerja ekziston në rastet kur dy apo më shumë persona kryejnë veprën penale duke marrë pjesë sëbashku në veprimin e kryerjes së asaj vepre. Sipas dispozitave ligjore

<sup>40</sup> Mantovani, Diritto Penale, parte generale, Padova ,2007, f.100

<sup>41</sup> V.Kambovski. E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme. Shkup 2010, fq 123

<sup>42</sup> <http://jus.igjk.rks-gov.net/727/1/Kodi%20Penal.pdf>

bashkëkryerës janë personat që veprimtarinë e tyre e kryejnë në formë të drejtpërdrejtë për të realizuar veprën penale. Për shembull, dy apo më shumë persona shtien me armë në drejtim të personit tjetër dhe i shkaktojnë vdekjen. Ndodh që të jetë i vështirë dallimi midis bashkëkryerjes dhe formave tjera të bashkëpunimit, prandaj është me rëndësi të bëhet dallimi i saktë midis tyre.

Për ta bërë dallimin midis bashkëkryerjes, si formë më e rëndë dhe formave tjera të bashkëpunimit, ekzistojnë tri teori: Teoria formale-objektive; teoria subjektive dhe teoria e ndarjes së veprimit (rolit). Teoria formale-objektive si bashkëkryerës e konsideron personin që ka ndërmarr veprimin e kryerjes apo një pjesë të veprimit të kryerjes, pra, kjo teori i merr për bazë vetëm elementet objektive të veprës penale dhe si bashkëkryerës e konsideron vetëm personin që ka ndërmarrë veprimin e kryerjes<sup>43</sup>, duke mos i marrë parasysh mënyrat tjera të kontributit në kryerjen e veprës penale, siç kishte me qenë shefi i bandës kriminale i cili në vendin e ngjarjes udhëheq operacionin e plaçkitjes së bankës. Teoria subjektive si bashkëkryerës i konsideron të gjithë pjesëmarrësit në kryerjen e veprës penale dhe kjo teori përfaqëson konceptin ekstensiv të nocionit të kryerësit, sipas të cilit edhe shtytësi edhe ndihmësi konsiderohen kryerës (bashkëkryerës) të veprës penale, me dallim se kanë trajtim të posaçëm me rastin e ndëshkimit, ku sipas teorisë subjektive bashkëkryerës konsiderohet çdo person që e ka dëshiruar pasojën dhe veprën e ka konsideruar si të vetën apo që vepron cum animo auctoris<sup>44</sup>. Teoria e ndarjes së veprimeve apo roleve të veprimit si bashkëkryerës e konsideron personin i cili në bashkëpunim me një person tjetër, duke bërë marrëveshje se si do ti ndjanë veprimet e tyre, e në këtë formë bëjnë realizimin e pjesëve të veta secili prej tyre në procesin e kryerjes së veprës penale, me ç'rast veprën e dëshiron si të vetën dhe si të përbashkët. Nga kjo teori rrjedh konkluzioni se cilindo pjesëmarrës ka marrë veprimin në suaza të marrëveshjes paraprake me personat tjerë dhe nëse ai person e ka dëshiruar kryerjen e asaj vepre penale, e bën bashkëkryerës të veprës penale.

---

<sup>43</sup> [https://google.com/url?sa=D&q=http%3A%2F%2Fjus.igik.rks-gov.net%2F670%2F%2FBashk%25C3%25ABpunimi%2520n%25C3%25AB%2520kryerjen%2520e%2520vepr%25C3%25ABs%2520penale\\_shqip.pdf](https://google.com/url?sa=D&q=http%3A%2F%2Fjus.igik.rks-gov.net%2F670%2F%2FBashk%25C3%25ABpunimi%2520n%25C3%25AB%2520kryerjen%2520e%2520vepr%25C3%25ABs%2520penale_shqip.pdf)

<sup>44</sup> Po aty



Praktika jonë gjyqësore kryesisht e ka përvetësuar atë teori që më së shpeshti na paraqitet si formë në praktikë dhe ajo është e ndarjes së roleve të bashkëkryesëve të veprave penale.

Kur vepra penale e cila mund të kryhet nga një person, mirëpo në kryerjen e saj vepra marrin pjesë dy apo më shumë persona, në këtë rast kemi të bëjmë për bashkëkryerje fakultative. Mirëpo, për shkak të natyrës së tyre ka disa vepra penale të cilat mund të kryhen vetëm nëse në veprimin e kryerjes marrin pjesë më shumë persona. Kjo formë e bashkëkryerjes na paraqitet si bashkëkryerje e domosdoshme. Nga bashkëkryerja e domosdoshme duhet dalluar bashkëkryerjen fiktive, e cila ekziston kur dy apo më shumë persona marrin pjesë në kryerjen e veprës penale, por që nuk kanë vepruar me vetëdije e as që e kanë dëshiruar apo pranuar pasojën. Veprat penale të kryera në bashkëkryerje të domosdoshme klasifikohen në veprat penale konvergjente dhe veprat penale divergjente. Veprat penale konvergjente ekziston kur bashkëkryerësit kanë qëllim të përbashkët, ndërkaq vepra penale divergjente ekziston kur bashkëkryerja është e domosdoshme, por bashkëkryerësit nuk kanë qëllim të përbashkët, apo kanë interesa të kundërta. Të tilla janë bashkëkryerja sukcesive, bashkëkryerja të veprat penale të përbëra dhe bashkëkryerja të veprat penale me mosveprim. Sipas nenit 25 të Kodit Penal të R. së Maqedonisë së Veriut, secili bashkëkryerës përgjigjet penalisht brenda kufijve të dashjes ose pakujdesisë së tij, kurse shtytësi dhe ndihmësi - brenda kufijve të dashjes së tyre<sup>45</sup>. Përkufizimi për kundërligjshmërinë e veprës rezulton nga përshkrimi që i bëhet veprës nga norma e caktuar. Vepra mund të jetë e kundërligjshme, por jo gjithmonë mund të përbëjë një vepër penale. Ajo mund të jetë kundërvajtje, të cilat janë të parapara në ligjin për kundërvajtje. Për shembull, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor mund të përbëjë kundërvajtje nëse nuk ka sjellë pasojat e parashikuara me ligj. Që një veprim ose mosveprim të jetë i kundërligjshëm, duhet të parashikohet nga norma penalo-juridike. Kërkesa e kundërligjshmërisë, buron nga parimi i ligjshmërisë i parashikuar në nenin 1 të Kodit Penal se “ Askujt nuk mund t’i shqiptohet dënim apo ndonje sanksion tjetër penal për vepër e cila para se të kryhet nuk është përcaktuar si vepër penale me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për të cilën nuk është paraparë dënim

---

<sup>45</sup> Kodi penal i RMV-së, neni 25

me ligji<sup>46</sup>". Parim ky i shprehur edhe me shprehjen: "Nullum crimen sine lege", "Nullum poena sine crimen"<sup>47</sup>. Kundërligjshmëria, duke e analizuar brendësinë së saj, është e natyrës objektive. Kjo përcaktohet duke vënë në relacion veprimin ose mosveprimin e individit me normat e së drejtës penale. Kësisoj, në të gjitha rastet kur sjellja e njeriut është në kundërshtim me normat e legjislationit penal, të cilat urdhërojnë apo ndalojnë ndonjë veprim, mund të konstatojmë se sjellja e njeriut është e kundërligjshme. Një veprim ose mosveprim si element përbërës i veprës penale që të jetë i kundërligjshëm duhet të vijë në kundërshtim me normat dhe rendin juridik, pra duhet të jetë në kundërshtim me ligjin. Kundërligjshmëria paraqet bazën juridike për përcaktimin e veprës penale. Në asnjë rast, veprimi ose mosveprimi nuk mund të përbëjë vepër penale pa u parashikuar shprehimisht në ligj një gjë e tillë. Përkufizimi për kundërligjshmërinë e veprës rezulton nga përshkrimi që i bëhet veprës nga norma e caktuar. Vepra mund të jetë e kundërligjshme, por jo gjithmonë mund të përbëjë një vepër penale. Ajo mund të jetë shkelje administrative ose civile. Për shembull, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor mund të përbëjë kundërvajtje nëse nuk ka sjellë pasojat e parashikuara me ligj. Ajo mund të përbëjë vepër penale kur ka sjellë ndonjërin prej pasojave që parashikohen në dispozitën e nenit 297 të Kodit Penal të RMV-së<sup>48</sup>.

Kryerja e veprës penale paraqet supozimin për zbatimin e dënimit ose të masave të paralajmërimit sipas kryesit të saj, si reaksion i domosdoshëm i shoqërisë-shtetit për lëndimin e shkaktuar ose rrezikimin e vlerave të mbrojtura me cenimin e normave të rendit juridik. Por, për tu zbatuar dënimi ose sanksioni i paralajmërimit për kryesit, është e domosdoshme që ai të jetë përgjegjës për veprën e kryer, d.m.th. të ketë raport të caktuar psikik për veprën e kryer si kryes i saj. Prandaj, për zbatimin e dënimit dhe masave të tjera (ose sanksioneve paralajmëruese), është e domosdoshme që përveç ekzistimit të veprës penale të ekzistojë edhe

---

<sup>46</sup> Kodi penal i RMV-së, neni 1

<sup>47</sup> V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesë e Përgjithshme, Shkup 2010, F. 201

<sup>48</sup> Kodi penal i RMV-së, neni 297 "Rrezikimi i sigurisë në komunikacion"

përgjegjësia penale për kryerësin e veprës. Nga kjo mund të konstatohet se, ekzistimi i përgjegjësisë penale është kusht i domosdoshëm për shqiptimin e dënimit ndaj kryesit të veprës penale. Përgjegjësia penale paraqet një grumbull kushtesh subjektive me të cilat përcaktohet gjendja psikike e kryesit të veprës dhe raporti i tij ndaj veprës penale<sup>49</sup>. Ajo përcaktohet si grumbull i kushteve subjektive të cilat e karakterizojnë kryerësin e veprës penale si të aftë mendor dhe fajtor (neni 11 KP i RMV-së). D.m.th. ky është nocioni genus i cili nënkupton aftësinë mentale dhe fajësinë. Nga ky nocion i përcaktuar mund të konstatohet se përgjegjësia penale është subjektive dhe kategori psikike. Krahas mendimit subjektiv, në teorinë e së drejtës ekziston dhe mendim objektiv-subjektiv i përgjegjësisë penale. Sipas këtij botëkuptimi, përgjegjësia penale përbëhet nga 3 elemente: 1) vepra penale (element objektiv), 2) aftësia mendore dhe 3) fajësia (element subjektiv). Përgjegjësia penale me të vërtetë presupozon ekzistimin e veprës penale, sepse problemi i përcaktimit të përgjegjësisë penale paraqitet pasi që është kryer një vepër e rrezikshme dhe e kundërligjshme shoqërore dhe me ligj është përcaktuar si vepër penale për të cilin parashihet dënimi.

Pa ekzistimin e veprës penale, nuk mund as të parashtrahet çështja e përgjegjësisë penale. Ky fakt na bën me dije se, përgjegjësia penale mund të kuptohet edhe në vështrimin objektiv-subjektiv. Në teorinë e së drejtës penale mund të hasim edhe në mendime të tilla sipas të cilave instituti qendror i kësaj fushe është fajtori i vërtete, por përgjegjësia penale paraqet vetëm konstatimin d.m.th. përcaktimin se një individ i përmbush kushtet për fajësi. Përgjegjësia penale kështu është vetëm pasojë e së veprës penale, ashtu siç është përgjegjësia juridiko-civile vetëm pasojë e kryerjes së deliktit juridiko-civil ose të deliktit civil (shkaktimi i dëmit). D.m.th. përgjegjësia penale është vetëm term teknik i cili tregon se një individ ka kryer vepër penale dhe që për atë vepër ai është përgjegjës. Kjo do të thotë se nocioni përgjegjësi penale ka vetëm karakter deklarativ, e jo thelbësor<sup>50</sup>. Duke filluar nga mendimi i paraqitur në dispozitën e nenit 11 të KP të RMV-së, që përgjegjësia penale është kategori subjektive dhe psikike e cila është e lidhur me personalitetin e kryesit të veprës penale, mund të vërejmë se ajo përbëhet nga dy elemente kryesore. Këto elemente janë, aftësia mendore dhe fajësia. Aftësia mendore

---

<sup>49</sup> Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.66

<sup>50</sup> Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.66

përcakton ekzistimin e aftësive psiqike te kryesi i veprës penale, të cilat e bëjnë të aftë ta kuptojë rëndësinë e veprave të tij dhe të udhëheqë me veprimet e veta. Fajësia përcakton ekzistimin e raportit të caktuar të kryesit ndaj veprës së tij si kryes i saj. Për t'ju ngarkuar vepra penale kryesit, është e domosdoshme përmbushja e dy elementeve. D.m.th. për ekzistimin e përgjegjësisë penale është i domosdoshëm ekzistimi i aftësisë mendore dhe fajësia (fajësia e cila paraqitet me paramendim ose nga pakujdesia). Kjo është e kuptueshme, se pa ekzistimin e aftësisë mendore nuk mund të ekzistojë as fajësia, duke pas parasysh që aftësia mendore është bazë mbi të cilën paraqitet fajësia. Në anën tjetër, aftësia mendore mund të ekzistojë dhe atëherë kur te kryesi nuk ka fajësi për veprën e kryer, në të dyja rastet nuk ka përgjegjësi penale, kështu që nuk mund të vijë as deri te dënimi për veprat e kryera në mungesë të elementeve të cekura më lartë. Aftësia mendore dhe fajësia mund të maten sipas shkalles, d.m.th. mund të ekzistojë shkallë më e lartë ose më e ultë e aftësisë mendore, si edhe shkallë më e lartë ose më e ultë e fajësisë, në varësi nga shkalla dhe intensitetit i paraqitjes së elementeve subjektive dhe psiqike (vetëdijes dhe dëshirës) të kryesit të rastit konkret. Kjo do të thotë se përgjegjësia penale mund të matet me shkallë. Ky fakt është shumë i rëndësishëm, sepse nga shkalla e përgjegjësisë penale, varet jo vetëm lloji dhe lartësia e dënimit për veprën e kryer, por në disa raste dhe ekzistimi i dënimit, dhe me këtë ekzistimi i veprës penale. Pasi që përgjegjësia penale është kusht për zbatimin e dënimeve sipas kryesit të veprës, ajo duhet të ekzistojë edhe në kohën e kryerjes se veprës penale. Kjo do të thotë se aftësia mendore dhe fajësia duhet të ekzistojnë në momentin e kryerjes të veprës penale në raport me veprën penale konkrete të kryer<sup>51</sup>.

Veprimi apo sjellja e caktuar e njeriut paraqitet si një ndër elementet bazike të çdo vepre penale. Për tu konsideruar një veprim relevant në të drejtën penale, ai duhet të jetë i vullnetshëm. I vullnetshëm konsiderohet ai veprim i cili është ndërmarrë dhe dirigjuar nga ana e personit të vetëdijshëm dhe në bazë të vullnetit të lirë. Sipas së drejtës penale, nuk do të konsiderohen si veprim dhe nuk do të ndëshkohen sjelljet apo veprimet që ndërmerren apo shkaktohen pa vetëdije, rastësisht apo nën ndikimin e dhunës apo kanosjes, p.sh, veprimi në gjumë, me ç'rast nëna ja zë frymën foshnjës së vetë të porsalindur dhe e mbyt, apo personi

---

<sup>51</sup> Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006, f. 66

duke ecur në trotuar për shkak të ngricës rrëshqet dhe me atë rast i shkakton lëndim tjetrit që është gjendur pranë tij<sup>52</sup>. Kurse personi vepron me vetëdije, përkundër vullnetit të tij, në rastin kur nën ndikimin e dhunës apo kanosjes, detyrohet të ndër marrë veprimin e caktuar, p.sh. kur personi A ia drejton revolen personit B që është duke punuar në sportelin e bankës dhe në këtë mënyrë e detyron që t'ia dorëzojë të gjitha të hollat që gjenden në kasafortë. Në të drejtën penale, si të rëndësishme na paraqiten vetëm ato veprime të njeriut të cilat i përgjigjen ndonjë veprimi të përcaktuar në figurën ligjore të veprës penale përkatëse dhe kur është në harmoni me parimet e ligjshmërisë së veprës penale<sup>53</sup>.

## 4.2 Shtytësi- Nxitësi

Kuptimi i bashkëpunimit sipas nenit 23 të Kodit Penal definohet si “Nxitja në kryerjen e veprave penale paraqet formën ku çdo person i cili me qëllim nxit tjetrin të kryej vepër penale, dhe për atë vepër do të dënohet sikur vetë ta ketë kryer atë vepër penale<sup>54</sup>”.

Nxitja na paraqitet si një nga format e bashkëpunimit në kuptimin e ngushtë. Në teori dhe në praktikë shtytja apo nxitja në kryerjen e veprave penale paraqet formën ku çdo person i cili me qëllim nxit tjetrin që të kryej vepër penale. Nxitësi për vepër që ka nxitur të kryhet, do të dënohet sikur ai vetë ta ketë kryer atë vepër penale. Rrjedhimisht del se për të ekzistuar shtytja, është e nevojshme që kryerësi të mos e ketë marrë vendimin për kryerjen e veprës penale apo mos ketë pasur aspak në plan apo ndërmend të kryej veprën penale, por nxitësi me veprimet e tij ndikon në forcimin e vendimit që ai të kryej veprën penale. Nxitja mund të kryhet vetëm me dashje, që do të thotë se nxitësi duhet të jetë i vetëdijshëm se me veprimin e

---

<sup>52</sup> Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006, f. 66

<sup>53</sup> ELEZI.I, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, 2008

<sup>54</sup> Kodi penal i RMV-së, neni 23

tij e nxit tjetrin në kryerjen e veprës së caktuar penale. Nxitja mund të bëhet edhe nga pakujdesia, por kjo formë e nxitjes nuk është e ndëshkueshme.

Nxitja si forme e bashkëkryerjes paraqet një formë dinake në organizimin e kryerjes së veprës penale. Kur kemi të bëjmë me nxitjen e krimeve kundër shtetit, atëhere kemi të bëjmë me kriminelë (nxitës) të rangut të lartë, nëse mund ti cilësoj si të tillë. Me organizim kuptohen ato veprime që shprehen në gjetjen e bashkëpunëtorëve, në përpunimin e planit kriminal për krijimin e organizatës dhe kryerjen e krimeve kundër shtetit, drejtimin direkt të veprimeve të pjesëmarrësve për realizimin e planit kriminal, në gjetjen e bazave për mbledhjet e organizatës. Me pjesëmarrje në organizatë kuptohen ato veprime (nxitje) që shprehen për realizimin e planit kriminal të organizatës.

Në këto raste bashkëpunëtori (nxitësi) do të përgjigjet sipas nenit që do të cilësohet vepra e anëtarit të organizatës. Krimi konsiderohej i kryer nga çasti i krijimit ose pjesëmarrjes në një organizatë kundër rendit kushtetues, pavarësisht nga krimet e kryera prej saj. Kjo ndodh për vetë rrezikshmërinë shumë të theksuar që paraqet vepra kriminale, e cila konkuron në çdo rast me krimet e tjera kundër shtetit.

### **4.3 Ndhmësi**

Ndhma është forma e tretë e bashkëpunimit në kuptimin e ngushtë. Bashkëpunëtori (ndhmës) nuk merr pjesë drejtpërdrejt në organizatë por i jep ndihmën e premtuar. Dhënia e ndihmës shprehet në dhënien e ushqimeve një ose disa pjesëmarrësve të organizatës, në fshehjen e tyre, dhënien e ilaceve për mjekim etj. Ndhma është ndërmarrje e veprimeve me të cilat një person me dashje ndihmon tjetrin të kryej vepër penale. Sipas KP të RMV-së Ndhma në kryerjen e një krimi do të konsiderohet veçanërisht: dhënia e këshillave ose udhëzimeve për mënyrën e kryerjes së krimit, vënia në dispozicion e mjeteve për kryerjen e veprës penale, heqja e pengesave për kryerjen e veprës penale, si dhe premtimi paraprak i fshehjes të

kryerësit të veprës penale, mjeteve me të cilat është kryer krimi, gjurmëve të veprës penale ose sendeve të marra gjatë kryerjes së veprës penale<sup>55</sup>.

Për dallim nga shtytja, ndihma mund të ekzistojë vetëm pasi personi tjetër ka vendosur të kryej veprën penale, në të kundërtën veprimet do të konsiderohen si shtytje. Ndhma mund të kryhet në mënyrë fizike dhe psikike. Si ndihmë fizike mund të konsiderohet vënia apo dhënia në disponim kryerësit mjetet për kryerjen e veprës penale apo mënjanimi i pengesave për kryerjen e veprës penale, kurse si ndihmë psikike konsiderohet dhënia e këshillave apo udhëzimeve si të kryhet vepra penale dhe premtimi se do ta fsheh veprën penale, kryerësin apo gjurmët e veprës penale. Ndhma e pasuksesshme ekziston atëherë kur personi që i është dhënë ndihma nuk e ka kryer veprën penale ose nuk ka tentuar ta kryej, apo nuk i ka ndërmarrë veprimet përgatitore të cilat janë të ndëshkueshme<sup>56</sup>. Ndhma e pasuksesshme do të ekzistojë edhe atëherë kur kryerësi nuk e ka shfrytëzuar ndihmën e tjetrit për kryerjen e veprës penale, por e ka kryer veprën pavarësisht nga veprimet e ndihmësit<sup>57</sup>.

## 5. FORMAT E BASHKËPUNIMIT

Duke karaharuar shtetin tone me ate të R. së Kosovës dhe të R. së Shqipërisë, R. e Shqipërisë ka evoluar gradualisht dhe Kodi i saj Penal dhe ligji i procedurës penale ka pësuar ndryshime më të shumta gradualisht.

Kemi cekur disa herë se bashkëpunimi definohet si kryerje e veprës penale nga dy ose më shumë individëve me marrëveshje midis tyre. Nga ky kufizim del se:

- nga ana objektive bashkëpunimi karakterizohet nga pjesëmarrja në kryerjen e veprës të dy ose më shumë personave,

---

<sup>55</sup> Kodi penal i RMV-së, neni 24

<sup>56</sup> <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fidoc.pub%2Fdocuments%2Fkodi-penal-i-rkosoves-8x4ee2wge343>

<sup>57</sup> I. Elezi, vep.cit. fq.185

- nga ana subjektive vepra penale e kryer në bashkëpunim karakterizohet nga faji në formën e dashjes të të gjithë bashkëpunëtorëve.

Kodi Penal konsideron si elementë thelbësorë e të domosdoshëm për bashkëpunim:

- marrëveshjen e bashkëpunëtorëve
- pjesëmarrjen për kryerjen e veprës penale të dy ose më shumë personave

Format e bashkëpunimit.

Sipas kodit penal të R.së Shqipërisë bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale realizohet në dy forma kryesore:

- Bashkëpunim i thjeshtë (neni 25 i Kodit Penal)
- Bashkëpunim i veçantë (neni 28 i Kodit Penal)

Me bashkëpunim të thjeshtë sipas nenit 25 të Kodit Penal kuptohet ajo formë e bashkëpunimit në të cilën pjesëmarrësit në kryerjen e veprës penale paraqiten në role të veçanta si organizatorë, nxitës, ndihmës dhe ekzekutorë<sup>58</sup>.

Si forma të bashkëpunimit të veçantë<sup>59</sup>, Kodi Penal parashikon:

- Organizatën kriminale
- Organizata terroriste
- Bandën e armatosur

---

<sup>58</sup> Kodi penal i R.së Shqipërisë, neni 25

<sup>59</sup> Kodi penal i R.së Shqipërisë, neni 28, Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 2;shfuqizuar paragrafi i dytë i pikës 1, ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 4



1. Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale<sup>60</sup>.

2. Organizata terroriste është një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste<sup>61</sup>.

3. Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale, të parashikuara në krerët V, VI dhe VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi<sup>62</sup>

Banda e armatosur ka këto karakteristika:

- pjesëmarrja e dy ose më shumë personave
- pjesëtarët e bandës duhet të jenë të armatosur (ose të paktën njëri prej tyre)
- ka një shkallë organizimi
- ka qëndrueshmëri për të kryer disa vepra penale.

Kodi Penal sa i përket bashkëpunimit e veçantë ndër vite solli këto ndryshime:

Për dallim nga Kodi Penal i vitit 1977, në Kodin Penal të vitit 2001 mungon grupi i organizuar si term apo formë e bashkëpunimit të veçantë. Kjo duket dhe nga tërësia e dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, ku në asnjërën prej tyre nuk përdoret termi grup i organizuar.

Në Kodin Penal të vitit 1977, organizimi i bandës së armatosur dhe i organizatës kriminale, parashikohej vetëm për krimet kundër shtetit, për dallim nga Kodi Penal i vitit 2001 i cili nuk e

<sup>60</sup> [https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi\\_Penal-1.pdf](https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf), neni 28, paragrafi 1

<sup>61</sup> [https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi\\_Penal-1.pdf](https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf), neni 28, paragrafi 2

<sup>62</sup> [https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi\\_Penal-1.pdf](https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf), neni 28, paragrafi 3

kushtëzon krijimin e bandës së armatosur dhe organizatës kriminale, dhe kryerjen e krimeve nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, me llojin e krimeve të kryera.

Bashkëpunimi na paraqitet si rrethanë rënduese në shumë dispozita ligjore të pjesës së posaçme të Kodit Penal.

Në botë themelohen edhe forma të bashkëpunimit regional me detyrë për të koordinuar luftën kundër formave të ndryshme të kriminalitetit. Kështu, në vitin 2003 nën patronazhin e Komisionit të sigurisë dhe bashkëpunimit evropian (KSBE) u themelua asociacioni policor që i përfshinë shtetet e Ballkanit jugperëndimor (të gjitha shtetet e ish RSFJ, Shqipërinë, Bullgarinë dhe Rumaninë) me detyrë që të organizuar luftën kundër krimit të organizuar që e ka prekur rajonin e përmendur, dhe vendet e Bashkimit evropian. Për një punë sa më efektive, është paraparë edhe stërvitja e kuadrove të policisë, pajisja teknike, formimi i bazave të përbashkëta kompjuterike etj.

### 5.1 Bashkëpunimi i thjeshtë

Gjatë studimeve shkencore mbi institutet themelore që karakterizojnë kodet penale, si tentativa, përgjegjësia e tentativës, pakujdesia, bashkëpunimi, bashkërealizimi i veprave penale, mbrojtja e nevojshme, vepra penale e cilësuar nga rrethana lehtësuese apo rënduese etj; vihet re aplikimi i vazhdueshëm i një terminologjie, e cila përdoret nga pjesa më e madhe e manualeve dhe komentareve të së drejtës penale të Italisë, Gjermanisë, Spanjës, Turqisë dhe vendeve të Amerikës Latine. Më ekzaktesisht, pjesëtarët e doktrinës së këtyre shteteve, të cilët përbëjnë pjesën dërrmuese të doktrinës botërore rreth “teorisë së përgjithshme të së drejtës penale”, e cila tashmë është pjesë e kulturës ndërkombëtare edhe të Shqipërisë dhe

vendeve të tjera të Ballkanit, përdorin shprehjen “*mënyrat e shfaqjes së veprës penale*”.<sup>63</sup>

Terminologjia në fjalë, shpreh një koncept të përgjithshëm, që synon të mbledh të gjitha ato raste në të cilat vepra penale përveç strukturës së saj elementare shfaq edhe disa elemente të tjerë, të cilët e bëjnë të ndryshojë nga prototipi. Ky i fundit identifikohet me faktin tipik, të kundërligjshëm, me faj apo me faktin objektivisht të paligjshëm me faj, i përbërë nga të gjithë elementët e tij (sjellja, elementi psikologjik, pasojat etj.), i cili realizohet nga një subjekt dhe përputhet me dispozitën e përkrahur në pjesën e posaçme të kodit penal.

Këtij modeli klasik të realizimit të veprës penale (i cili identifikon veprën penale të konsumuar në mënyrë të thjeshtë, monosubjektive), i kundërvihen disa mënyra (forma) alternative me anë të cilave vepra penale mund të shfaqet konkretisht.<sup>64</sup> Mund të ndodh që vepra penale të paraqitet e përcaktuar sepse, nuk realizohet prekja e të mirës juridike drejt së cilës sjellja ishte drejtuar (p.sh X qëllon me pistoletë në drejtim të Y-it, por gabon shënjestrën dhe gjuajtja shkon bosh), ose sepse sjellja me anë të së cilës realizohet vepra penale nuk përfundohet p.sh, Z hyn në një banesë për të vjedhur, por pasi shikon të zotin e shtëpisë largohet pa përvetësuar asnjë send.<sup>65</sup> nga ana fenomenologjike është krejt ndryshe nga fakti i realizuar. Pra, një gjë është vrasja e një njeriu, që do të thotë përfundimi i funksioneve jetësore të tij, tjetër është tentativa për të vrarë një njeri ku fenomeni i vdekjes nuk realizohet. Por për të ndëshkuar këtë tenton, duhet që dispozitës që parashikon një vepër penale t’i shtohet, në mënyrë normative, tipiciteti me anë të një dispozite, e cila parashikon tentativën. Si rrjedhim, në rastin e vrasjes së mbetur në tentativë do të aplikohet neni 76 (vrasja) dhe neni 22 i Kodit Penal (tentativa). Pra, kemi të bëjmë me një fenomen integrimi

---

<sup>63</sup> Për herë të parë shprehja: “*mënyrat e shfaqjes së veprës penale*”, në fjalë është përdorur rreth 1910 në Gjermani nga Beling dhe shprehja ishte “*erscheinungsformen*”. Ferrando MANTOVANI, *Diritto penale*, Padova, 2007.

<sup>64</sup> Carlo FIORE – Stefano FIORE, *Diritto penale*, Botimi i III, Milano 2008

<sup>65</sup> Mbi konceptin e tentativës në doktrinën shqiptare: Ismet ELEZI – Skënder KAÇUPI – Maksim HAXHIA, *Komentari i kodit penal të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2006. SH. MUÇI, *E drejta penale, pjesë e përgjithshme*, Tiranë, 2007.

dispozitash.

Gjithashtu, vepra penale mund të jetë fryti i bashkëpunimit të disa njerëzve, vullnetet e të cilëve konvergojnë në realizimin e një pasoje të dëmshme për të mirën juridike. P.sh A, B dhe C nisen për të bërë një vjedhje. A futet në banesën e marrë në shënjestër, B bën roje poshtë banesës për të parë mos vijnë të zotët e shtëpisë, C është gati me makinën e ndezur për tu nisur menjëherë pas vjedhjes.

Raste e marra në shqyrtim i përgjigjen figurave të tentativës dhe të bashkëpunimit në veprën penale monosubjektive. Bëhet fjalë për raste të parashikuara në ligj me anë të të cilave ligjvënësi shtrin tipicitetin, i cili në teorinë e përgjithshme të veprës penale përdoret si në lidhje me faktet e parashikuara nga ligji si vepër penale, ashtu edhe për institutet e tjerë të parashikuara në kodet penale, të cilët modifikojnë ose orientojnë kuptimin e faktit tipik. P.sh tipike është dispozita e bashkëpunimit.

## 5.2 Bashkëpunimi i veçantë

Bashkëpunëtori është person fizik i cili në mënyrë të vetëdijshme, të organizuar dhe të fshehtë, me detyra të marra nga personi zyrtar i autorizuar, jep njoftime dhe të dhëna për veprat penale dhe kryesit e tyre, si dhe fakte të tjera që janë me rëndësi për të zhvilluar aktivitetet punuese në sferën e resorit të shërbimit të sigurisë publike. “Do me thënë, bashkëpunëtori gjendet të jetë shumë afër veprimtarisë kriminele, nëpërmjet tij zhvillohet përpunimi kriminalistik, ai në mënyrë permanente dhe të vazhdueshme mbledh të dhëna , i mundëson policisë zbatimin e mjeteve të veçanta operative – teknike etj<sup>66</sup>. Bashkëpunëtori, kryesisht mund të angazhohet me pajtimin e mëparshëm në forma të shkruar, përkatësisht me leje të udhëheqësit të organit përkatës. “Prej kësaj mund të ketë edhe përjashtime, për shkak të rrethanave adekuate (të situatës të veçantë taktike), nëpunësi operativ nuk ka kohë për të bërë propozim në formë të shkruar, prandaj me gojë e informon udhëheqësin i cili vendos për angazhimin e tij, duke e obliguar në të njëjtën kohë nëpunësin operativ që sa më shpejtë të bëjë propozim në formë të shkruar”. Nuk është e lejuar që personi zyrtarë i autorizuar në emër të shërbimit, ti japë

---

<sup>66</sup> I. Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2005,

premtime të cilat nuk mund ti plotësojë. Terminët e ndryshme të bashkëpunimit kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe varen nga raporti i përgjithshëm ndaj bashkëpunëtorit, motiveve të tyre për bashkëpunim, përmbajtja dhe qëndrimet ndaj vlerave të raportit interakcional të policisë ndaj rrjetit të bashkëpunëtorëve në tërësi, zhvillimit të demokracisë dhe raportit të policisë dhe opinionit në përgjithësi<sup>67</sup>. Procesi i realizimit të bashkëpunimit nënkupton informim të përhershëm dhe aktual. Bëhet fjalë për informacione relevante, si rezultat i marrëdhënieve interaksionale të relacionit: nëpunës operativ – bashkëpunëtorë- objekte të interesit- shërbime të policisë. Duke plotësuar obligimin e vet bashkëpunëtori aktiv është realizues i detyrave operative. Nëpërmjet aktiviteteve të tilla, bashkëpunëtori shpesh barazohet me nëpunësin e operativ, për të vetmin shkak sepse edhe ai është kreator i aktiviteteve operative. Gjithashtu bashkëpunëtori pranon në mënyrë të vetëdijshme dhe me përgjegjësi kryerjen e obligimeve dhe të detyrave të caktuara duke paraqitur edhe mendimin dhe propozimet e veta. Posaçërisht gjatë ndryshimit dhe plotësimit të planit në situatë konkrete operative – taktike. Vet iniciativa , mundësia dhe dhuntia për tu gjendur gjatë situatave të ndryshme, marrjes me kohë të vendimeve nëpërmjet kombinimit kreativ e të tjera, janë supozime. elementare gjatë veprimit të bashkëpunëtorit në të gjitha situatat kriminalistike-taktike<sup>68</sup>.

---

<sup>67</sup> Petar Novoselac, *Opći dio kaznenog prava*, Zagreb, 2007,

<sup>68</sup> I. Elezi etj., *Komentari i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2006.

## KAPITULLI II

### PËRGJËGJESIA E BASHKËPUNËTORËVE NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE

#### 1. Kodi Penal i RMV-së

Sipas Kodit Penal të RMV-së, Organizatorët, shtytësit (nxitësit) dhe ndihmësit kanë përgjegjësi të njëjtë si kryerësit e veprave penale. Kur gjykata bën caktimin e dënimit të bashkëpunëtorët, ajo duhet të marrë parasysh disa elemente si shkallën e pjesëmarrjes së secilit dhe rolin e luajtur të bashkëkryerësit në kryerjen e veprës penale. Organizata kriminale definohet si formë më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën marrin pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohen nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale.

Në Kodin Penal të RMV-së, këto forma të kryerjes së veprave penale, gjegjësisht, bashkëpunimi për kryerje të veprave penale, janë përshkruar në kapitullin e tretë, në nenin 22, 23 dhe 24, d.m.th., na paraqitet në tri forma të cilat janë: bashkëkryerja, shtytja dhe ndihma<sup>69</sup>.

- Bashkëkryerje-

Bashkëkryerja e veprave penale paraqet formën ku, nëse dy ose më shumë persona, duke marrë pjesë në një akt të kryerjes ose me një kontribut tjetër të veçantë për kryerjen e një veprave penale, bashkërisht kryejnë një vepër penale, secili prej tyre do të dënohet me dënimin e paraparë për atë vepër.

-Nxitje-

Nxitja në kryerjen e veprave penale paraqet formën ku çdo person i cili me qëllim nxit tjetrin të kryej vepër penale, dhe për atë vepër do të dënohet sikur vetë ta ketë kryer atë vepër penale.

---

<sup>69</sup> Kodi penal i RMV-së

-Ndhimja-

Si dhe ndihma në kryerjen e veprave penale është ajo formë e ndihmës ku çdo person i cili me qëllim ndihmon tjetrin për të kryer një vepër penale, do të dënohet sikur vetë ta ketë kryer atë vepër penale

Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste apo bandë cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parimeve të pjesës së veçantë të Kodit ose sipas dispozitave të tjera penale të veçanta. Anëtarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, ose bandës bartin përgjegjësi për të gjitha veprat penale, të kryera prej tyre, të cilët kanë pasur për qëllim të veprimtarisë së tyre kriminale. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste ose bandës, përfiton përjashtimin nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë në zbulimin dhe njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve pjesëmarrës.

Me burgim prej një deri në pesë vjet do të dënohet personi i cili krijon grup ose bandë që synon të kryejë vepra penale për të cilat mund të shqiptohet dënim me burgim prej tre vjetësh ose dënim më i rëndë<sup>70</sup>, kështu e parasheh ligjvënësi nenin 394 të Kodit penal të RMV-së.

Sa i përket bashkëpunëtorëve apo anëtarëve të grupit ose i bandës do të dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet<sup>71</sup>.

Kurse, anëtari i grupit ose bandës që e zbulon grupin, përkatësisht bandën, para se të kryejë vepër penale në përbërjen e saj ose për të, lirohet nga dënimi<sup>72</sup>.

## **2. Ligji i procedurës penale i RMV**

Qëllimi i ligjit apo ky ligji i përcakton rregullat me të cilat mundësohet udhëheqje e drejtë e procedurës penale, ashtu që asnjë i pafajshëm të mos dënohet, kurse kryeresit të vepres penale t'i shqiptohet sanksion penal me kushtet e parapara në Kodin penal dhe në baze

---

<sup>70</sup> Neni 394 i Kodit penal të RMV-së, paragrafi 1

<sup>71</sup> Neni 394 i Kodit penal të RMV-së, paragrafi 2

<sup>72</sup> Neni 394 i Kodit penal të RMV-së, paragrafi 3

të procedurës së zbatuar ligjore. Prezumimi i pafajesise<sup>73</sup> parasheh se “personi i akuzuar për veper penale do të konsiderohet si i pafajshëm derisa faji i tij nuk percaktohet me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor”. Organet shtetërore, mjetet për informim publik dhe subjektet tjera janë të obliguara që t'i permbahen rregullës nga paragrafi (1) të këtij neni, kurse me deklaratat e veta publike për procedurën që është në rrjedhë nuk guxojne t'i shkelin të drejtat e të akuzuarit dhe të demtuarit, si dhe pavaresinë dhe paanësinë gjyqësore.

Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit parasheh se para se të miratohet aktgjykim i plotfuqishëm, lirite dhe të drejtat e të akuzuarit dhe të personave të tjere në menyre proporcionale me peshën e veprës penale dhe shkallën e dyshimit, mund të kufizohen vetem në masë që është e domosdoshme dhe me kushte që i parashikojnë Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, marreveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetuten e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe këtij ligji. Sanksionin penal kryeresit të vepres penale mundet me vendim t'ia shqiptojë vetem gjykata kompetente, në procedur[ të zbatuar sipas këtij ligji<sup>74</sup>.

### 3. Legjislacioni penal për krimin e organizuar

Krimi si fenomen shoqëror dhe individual si dhe shkaqet e tij, kanë qenë përherë objekt interesimi, që nga paraqitja e shoqërisë njerëzore. Qysh nga kohërat më të hershme, ka patur përpjekje që të shpjegohet arsyeja dhe shkaku se çka i shtyn disa individë dhe grupe të kryejnë krime. Shpjegimet e paraqitjes së këtij fenomeni, kanë qenë të ndryshme dhe shpesh të përcjellura me misticizëm dhe interpretime iracionale e jo të drejta. Këto qasje, lidhur me shkaqet e krimit, kanë qenë të varura nga shkalla e civilizimit, orientimet ideore dhe përcaktimet profesionale, si dhe prej nivelit shkencor të autorëve të cilët i kanë parashtruar. Interesimi i opinionit për krimin ka qenë permanent, ngase të gjitha shoqëritë njerëzore janë

---

<sup>73</sup> Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.150/2010

<sup>74</sup> Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.150/2010



kacafytur me këtë dukuri të rrezikshme dhe përherë kanë bërë përpjekje ta pengojnë. Orvatjet e luftimit të krimit vërehen që nga ndalesat apo tabutë e para në shoqëritë primitive, e deri te inkriminimet e shumë sjelljeve si krime e vepra penale, në kodet penale bashkëkohore. Me të drejtë, disa autorë konstatojnë se historia e civilizimit është në të njëjtën kohë edhe historia e krimit, sepse historia njerëzore ka kaluar nëpër ngjarje e kohëra të përcjella me dhunë e krime të llojllojshme. Për shkak të natyrës së vet shkatërruese, krimi përherë ka zgjuar frikë, pasiguri dhe tmerr ndër qytetarë, duke shtuar në të njëjtën kohë interesimin për të. Prandaj, në të gjitha fazat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, është shprehur një interesim i veçantë për natyrën, shkakun dhe motivet e krimit si dhe për pasojat shpesh tragjike dhe mënyrën e pengimit dhe dënimit të tij. Misteri i krimit dhe i dënimit të tij, ka qenë objekt trajtimi nga shumë mendimtarë, filozofë, shkrimtarë dhe krijues të tjerë të artit. Për krimin, për vrazhdësinë, mizorinë dhe bizaritetin e tij, janë thurur legjenda, përralla dhe tregime nga popuj të ndryshëm të botës.<sup>75</sup> Krimi dhe sjelljet e ndryshme kriminale në botën e sotme, janë bërë temë dite e medieeve të shkruara dhe elektronike. Programet filmike, televizive, video – klubet, faqet e internetit dhe repertuaret e kinemave, janë përplot me tema dhe përmbajtje të krimeve të dhunës, vrasjeve, dhunimeve seksuale, kidnapimeve, akteve terroriste, plaçkitjeve, pornografisë, aferave, skandaleve dhe sjelljeve tjera patologjike dhe kriminale. Këto përmbajtje që prezantohen, shpesh janë të ngarkuara me ngjarje e imazhe morbide e mizore të cilat ndër lexues e shikues përcjellin porosi negative, duke nxitur e zgjuar ndjenja dhe instinkte të ulëta, sidomos të miturit dhe të rinjtë. Me vite të tëra, disa gazeta e revista të verdha bulevardeske, mbajnë tirazh të lartë, duke preokupuar vëmendjen e opinionit me shkrime për raste e ngjarje të krimeve më bizare, për afera e skandale të qarqeve të larta, për korrupsion, për veprimet delikuede të elitave të politikës, biznesit, yjeve të filmit, yjeve të sportit kulminant për konsumimin e drogës dhe për veprime të tjera<sup>1</sup>. Në këtë mënyrë tema e krimit është prezente në të gjitha poret e jetës së njeriut në shoqërinë bashkëkohore. Për këtë arsye, mund të shtrohet pyetja: prej nga gjithë ky interesim dhe preokupim i opinionit, cilat janë arsyet dhe sjaqet e tij? Duke u nisur nga fakti

---

<sup>75</sup> Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2005, fq. 10 - 11

se krimi i organizuar është një formë e kriminalitetit që ka kaluar kufijtë nacional dhe po merr gjithnjë e më shumë attribute të një krimi ndërkombëtar, me pasoja të shumta për njerëzimin, si dhe në mungesë të përkufizimeve të qarta të legjislacioneve nacionale përkitazi me këtë dukuri, deri më tani janë shënuar disa përpjekje serioze në drejtim të përkufizimit të këtij nocioni nga autorët e ndryshëm si dhe nga bashkësia ndërkombëtare, e veçmas nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Kësisoj, janë nxjerrë edhe konventa me karakter ndërkombëtar që kanë të bëjnë me përcaktimin e elementeve të grupit të organizuar kriminal si dhe me parashikimin edhe të disa masave me qëllim të luftimit dhe parandalimit të tij. Këto nisma të organizatave ndërkombëtare kanë ndihmuar në masë të madhe edhe legjislacionet e vendeve të ndryshme, të cilat me rastin e përcaktimit të elementeve të kësaj dukurie kriminale si dhe të parashikimit të masave dhe mjeteve të luftimit të saj, kryesisht si pikëmbështetje kanë pasur përkufizimet dhe qasjet ndërkombëtare. Sipas të dhënave nga literatura mund të konstatojmë se termi ``krim i organizuar`` për herë të parë është përdorur në vitin 1896, në një raport vjetor të Shoqatës për Parandalimin e Krimin, në Nju-Jork. Në këtë raport ky term përdorej për veprimet e ndaluara të bixhozit dhe prostitucionit, të mbrojtura nga zyrtarët publik. Kjo lenë të kuptohet se si krim i organizuar fillimisht janë konsideruar bizneset ilegale në të cilat kanë qenë të përfshirë politikanët, oficer policie, jurist apo vjedhës profesional, krimet e të cilëve konsideroheshin si krime të organizuara. Sipas Enciklopedisë mbi krimin dhe ndëshkimin:

``Krimi i organizuar mundet përgjithësisht të përkufizohet si konspiracion i përbashkët i dy ose më shumë personave në baza të vazhdueshme dhe të fshehta, me qëllim të kryerjes së një apo më shumë krimeve të rënda dhe me qëllim të sigurimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të përfitimit financiar apo përfitimit tjetër material<sup>76</sup>. Në Evropë, përpjekjet e para për të përkufizuar krimin e organizuar janë shënuar aty rreth viteve të 80 – ta të shekullit të kaluar. Këto përpjekje për të dhënë një përkufizim të krimin të organizuar janë bërë edhe në nivel ndërkombëtar.<sup>77</sup> Grumbullimi i kapitalit në duart e kriminelëve ka mundësuar krijimin e

---

<sup>76</sup><https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fknowledgecenter.ubt-uni.net%2Fcgi%2Fviewcontent.cgi%3Farticle%3D1376%26context%3Ddetd>

<sup>77</sup> Prof. Dr. Rexhep Gashi, Krimi i Organizuar, Prishtinë 2011, fq.13 – 14

një shtrese të keqbërësve, që zhvillojnë fuqinë private, që e shfrytëzojnë në mënyrë të pamëshirshme dhe në këtë mënyrë kërcënojnë çdo qytetar, si dhe vetë shtetin juridik. Krimi i organizuar nxit interes të posaçëm në të drejtën bashkëkohore penale dhe në politikën e luftimit të kriminalitetit. Krimi i organizuar ka qenë një nga temat e trajtuara në kongresin XVI të Shoqatës Ndërkombëtare për të Drejtën Penale (Association Internationale de Droit Penal, International Association of Penal Law), të mbajtur në vitin 1999, në Budapest<sup>78</sup>. Rezolutat e miratuara kanë përfshirë edhe problemet e konfiskimit të dobisë pasurore, kështu që për pjesën e përgjithshme të kodit penal është përcaktuar që sanksionet penalo – juridike domosdo duhet të jenë adekuate me rrezikueshmërinë e caktuar nga krimi i organizua, dobia pasurore duhet konfiskuar. Dobia pasurore është një nga motivet themelore për organizatat kriminale dhe veprimtarinë e individëve brenda organizatave të këtilla. Karakteristikë e rëndësishme e krimit të organizuar është që dobia pasurore e fituar me vepër penale të `strehohet` në vend të sigurt, që të pamundësohet konfiskimi i saj. Nuk janë raste të rralla kur pjestarët e organizatave kriminale të arrestuar dhe të gjykuar në territorin e një shteti, kurse pasuria të cilën e ka fituar me anë të kriminalitetit dhe që ajo pasuri duhet t`i konfiskohet që për te cilën duhet të kemi një vendimit gjyqësor, të gjendet në territorin e një shteti tjetër. Për këtë, Kombet e Bashkuara kanë përpunuar mekanizmin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Konventa e Kombeve të Bashkuara përcakton që shtetet palë janë të obliguara që njëra – tjetrës t`i ofrojnë ndihmën më të madhe të mundshme juridike në hetime, ndjekje dhe procedura gjyqësore<sup>79</sup>.

---

Prof. dr. Vesel LATIFI – Prof. as. Dr. Agron BEKA, Vrasjet, Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi, Prishtinë, 2013, fq. 89-90

<sup>78</sup><https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fknowledgecenter.ubt-uni.net%2Fcgi%2Fviewcontent.cgi%3Farticle%3D1376%26context%3Ddetd>

<sup>79</sup>Prof. dr. Vesel LATIFI – Prof. as. Dr. Agron BEKA, Vrasjet, Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi, Prishtinë, 2013, fq. 89-90

#### 4. Aktet ndërkombëtare

Sipas ligjit i bashkëpunimit nderkombetar ne materien penale, rregullohen kushtet dhe procedura e bashkëpunimit ndërkombëtar në materien penale (në tekstin e mëtejme: bashkëpunimi ndërkombëtar).

Bashkëpunimi ndërkombëtar jepet në të gjitha procedurat në lidhje me veprat penale, ndjekja e të cilave në kohën e parashtrimit të lutjes për ndihmën juridike ndërkombëtare në materien penale ose kërkesën për bashkëpunim ndërkombëtar në materien penale, është në kompetencë të organit të jurisprudencës së shtetit kërkues. Bashkëpunimi ndërkombëtar jepet në procedurat para Gjykatës Europiane së të Drejtave të Njeriut, Gjykatës Europiane të Drejtësisë, Gjykatës Penale Ndërkombëtare, dhe kur përcaktohet me marrëveshje ndërkombëtare dhe në lidhje me organizatat e tjera ndërkombëtare, anëtare e së cilës është Republika e Maqedonisë së Veriut. **Vendimi i Këshillit 2007/845 / JHA nga 6 dhjetor 2007 për bashkëpunim ndërmjet zyrave për konfiskimin e dobisë pronësore të** për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar në materien penale, të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ligj, do të zbatohen dispozitat e Ligjit të Procedurës Penale, Ligjit të Kundërvajtjes, Ligjit të Gjykatave, Ligjit të Prokurorisë Publike dhe Ligjit të Parandalimit të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave. Me këtë ligj bëhet harmonizimi me: VENDIMIN 187/2002 /JHA E KËSHILLIT nga 28 shkurt 2002 për themelimin e EUODREJTËSISË me qëllim që ta përforcojë luftën kundër krimit serioz<sup>80</sup>. CELEX 32002D0187, VENDIMIN 659/2003 /JHA E KËSHILLIT nga 18 qershor 2003 për ndryshimin e VENDIMIT 187/2002/JHA E KËSHILLIT nga 28 shkurt 2002 për themelimin e EUODREJTËSISË me qëllim që ta përforcojë luftën kundër krimit serioz<sup>81</sup>. CELEX 32002D0187, VENDIMIN 426/2009 /E KËSHILLIT nga 16 dhjetor 2008 për përforcimin e EUODREJTËSISË dhe ndryshimin e VENDIMIT 187/2002/JHA E KËSHILLIT nga 28

---

<sup>80</sup> <https://www.slvesnik.com.mk/issues/5d858e6fa8084b6cb6450d2b787aef83.pdf>

<sup>81</sup> Po aty

shkurt 2002 për themelimin e EUODREJTËSISË me qëllim që ta përforcojë luftën kundër krimit serioz<sup>82</sup>. CELEX 32002D0426, Vendimi i Këshillit 2007/845 / JHA nga 6 dhjetor 2007 për bashkëpunim ndërmjet zyrave për konfiskimin e dobisë pronësore të vendeve anëtare në fushën e ndjekjes dhe përcaktimit të dobisë pronësore të fituar me veprë penale ose pronë tjetër lidhur me veprën penale CELEX 32007D0845, VENDIMI 976/2008/JHA E KËSHILLIT nga 16 dhjetor 2008 për Rrjetin Evropian të Jurisprudencës, CELEX 32008D0976, VENDIMI KORNIZË 783/2006 / JHA E KËSHILLIT nga 06 tetor 2006 për zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të urdhrave për konfiskim CELEX 32006F0783<sup>83</sup>.

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon: "Organi kompetent vendor" është Ministria e Drejtësisë, ose organi gjyqësor vendor që vepron sipas kërkesave për bashkëpunim ndërkombëtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, "Organi i huaj kompetent" është organi i shtetit të huaj i cili sipas legjislacionit të shtetit të huaj, përkatësisht sipas marrëveshjes ndërkombëtare është kompetent për bashkëpunim ndërkombëtar, "Organi vendor i jurisprudencës" është gjykata ose prokuroria publike të cilat me ligj janë kompetente për bashkëpunim ndërkombëtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, "Shteti kërkues" është Republika e Maqedonisë së Veriut ose shteti i huaj, organi kompetent i të cilit ka parashtruar kërkesë për bashkëpunim ndërkombëtar në materien penale në fushën e bartjes së procedurave penal, ekstradimit, kryerjes së gjykimeve të huaja penale dhe transferimit të personave të dënuar, "Shteti nga i cili kërkohet bashkëpunimi ndërkombëtar" është Republika e Maqedonisë së Veriut ose shteti i huaj, organi kompetent i të cilit vepron sipas kërkesës për bartjen e procedurave penale, ekstradimit, kryerjes së gjykimeve të huaja penale dhe transferimit të personave të dënuar, "Shteti lutës" është Republika e Maqedonisë së Veriut ose shteti i huaj, organi kompetent i të cilit ka parashtruar lutje për ndihmë juridike ndërkombëtare, "Shteti i lutur" është Republika e Maqedonisë së Veriut ose shteti i huaj, organi kompetent i të cilit vepron sipas lutjes për ndihmë juridike ndërkombëtare, "Lutja për ndihmë juridike ndërkombëtare" është akti me të cilin kërkohet ndihmë juridike ndërkombëtare dhe "Kërkesë për bashkëpunim ndërkombëtar në materien penale" është akti me të cilin kërkohet

---

<sup>82</sup> Po aty

<sup>83</sup> Po aty

bashkëpunimi ndërkombëtar në materien penale në fushën e bartjes së procedurave penale, ekstradimit, kryerjes së gjykimeve të huaja penale dhe transferimit të personave të dënuar.

## 5. Konventat ndërkombëtare

Për arsye të dukshme të mbrojtjes sociale dhe të rendit publik, çdo Shtet e deklaron veten si kompetent për të dënuar veprat e kryera në territorin e tij. Këto janë vepra penale kundër ligjit të Shtetit në fjalë, i cili duhet të respektohet nga të gjithë personat që janë në territorin e këtij vendi. Pra, e drejta për të dënuar, varet kryesisht nga vendi i kryerjes së shkeljes. Juridiksioni i përcaktuar mbi këtë bazë është legjislativ dhe gjyqësor. Kur pretendohet se është kryer një vepër penale në territorin e një shteti, gjykatat penale të atij shteti janë gjykatat kompetente, dhe, sipas rregullit përgjithësisht të pranuar, aplikohet absolutisht dhe pa kufizim e drejta penale kombëtare<sup>84</sup>. Një tendencë e tillë ka një mangësi serioze – ka rrezik që rastet e juridiksionit aktual ndërmjet Shteteve të shumëfishohen, dhe, si pasojë, të shumëfishohen edhe konfliktet pozitive të juridiksionit dhe legjislacionit. Kjo për shkak të faktit se zgjidhja e këtyre konflikteve krijon probleme të vështira me arsyetimin e të drejtës së barabartë të sovraniteteve të përfshira për të dhënë dënimin. Sovraniteti i dytë në përgjithësi do të ketë mjete më të besueshme informacioni në dispozicion, ndërsa i pari do të jetë në gjendje të pretendojë interesa më të drejtpërdrejta. Dënimi nga një gjykatë e huaj nuk mund të cenojë të drejtën e një Shteti sovran për të dënuar. Zgjidhja mund të ofrohet vetëm nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Shtetet Kontraktuese marrin përsipër të harmonizojnë ushtrimin e të drejtave për të vënë sanksione. Juridiksioni territorial mund të përcaktohet për rregulla të ndryshme. Ai mund të bazohet në aktin penal ("teoria e aktit") ose në pasojën e tij, ose, ndonjëherë, në të dyja këto elementë të kombinuar<sup>85</sup>. "Teoria e Aktit" lidhet me Shtetin brenda territorit të së cilit ka ndodhur aktiviteti kriminal si shteti i vetëm i interesuar për dënimin e aktit<sup>86</sup>. Shteti në territorin e të cilit vepra ka prodhuar efektet e saj, gjithsesi, në rrethana të

---

<sup>84</sup> <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Frm.coe.int%2F16806ed48b>

<sup>85</sup> Po aty

<sup>86</sup> Po aty

caktuara, mund të pretendojë një interes më të menjëhertë në dënimin e tij. Sot, pjesa më e madhe e sistemeve ligjore, ose të paktën sistemi ligjor i Shtetet anëtare të KE-së ( Këshillit të Evropës), njohin juridiksionin e të dyja shteteve, atë të shtetit ku është kryer vepra dhe atë të shtetit që pëson pasojën. Kjo është dega e së drejtës ndërkombëtare që është krijuar për të kërkuar para ligjit individët që janë përgjegjës për shkelje veçanërisht të rënda të së drejtës ndërkombëtare. Ideja se individët, dhe jo vetëm shtetet, mund të shpalleshin përgjegjës për shkelje të tilla filloi të fitonte terren pas Luftës së Dytë Botërore me krijimin e gjykatave të Nurembergut dhe Tokios, të cilat u krijuan për të ndjekur penalisht personat përgjegjës për krime mizore.

Kjo degë e së drejtës ndërkombëtare publike merret me krimet ndërkombëtare: d.m.th., krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, gjenocidin dhe potencialisht, agresionin. Një nga pasojat ligjore të inkuadrimin të një akti si një krim ndërkombëtar është se shtetet duhet të ndjekin penalisht dhe të ndëshkojnë për kryerjen e tij, duke përfshirë ushtrimin e juridiksionit universal, i cili lejon - ose madje detyron - çdo shtet të gjykojë autorët e dyshuar të pranishëm në një territor nën juridiksionin e tij, edhe në mungesë të ndonjë lidhjeje ndërmjet të akuzuarit dhe shtetit që ushtron juridiksionin.

Konventat e Gjenevës dhe Protokolli Shtesë i përcaktojnë se disa shkelje të së Drejtës ndërkombëtare humanitare duhet të konsiderohen "shkelje të rënda" dhe ato duhet të ndiqen penalisht nga Palët e Larta Kontraktuese në bazë të parimit të juridiksionit universal. Shkelje të tjera të rënda të së Drejtës ndërkombëtare humanitare (DNH) përcaktohen nga e drejta zakonore ndërkombëtare dhe nga traktatet e së drejtës penale ndërkombëtare. Shkeljet e tilla të rënda të DNH-së, së bashku me shkeljet e rënda, përbëjnë krime lufte.

Jurisprudenca e gjykatave penale ndërkombëtare ka kontribuar shumë në sqarimin e shumë çështjeve të DNH-së. Për shembull, vendimi i Tadiqit i dhënë nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë konsolidoi kriteret në bazë të të cilave një situatë mund të klasifikohet si një konflikt i armatosur jondërkombëtar.

Sistemi aktual i së drejtës penale ndërkombëtare zbatohet përmes sistemeve kombëtare (gjykatat ushtarake dhe gjykatat e zakonshme) si dhe gjykatat ad hoc

ndërkombëtare, gjykatat e ndërkombëtarizuara ose të përziera dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare.

## 6. Përgjegjësia penale dhe caktimi i dënimit për bashkëpunëtorët në bashkëpunimin e thjeshtë

Mosnjohja e ligjit që dënon veprën penale, nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja është objektivist e paevitueshme<sup>87</sup>. Në kodin penal të RMV-së është i paraparë në nenin 11 dhe thontë: penalisht është përgjegjës kryerësi i cili ka kryer veprën me dashje ose nga pakujdesija dhe ka qenë i vetëdijshëm ose i detyruar dhe mund të ketë qenë në dijeni për inkriminimin e veprës<sup>88</sup>.

Nuk ka përgjegjësi penale personi i cili në kohën e kryerjes së krimit nuk ka mundur të kuptojë kuptimin e krimit të tij ose nuk ka mundur të menaxhojë veprimet e tij për shkak të sëmundjes së përhershme ose të përkohshme mendore, çrregullimit të përkohshëm mendor ose zhvillimit të vonuar mendor, ose çrregullimeve të tjera veçanërisht të rënda mendore nuk është i përgjegjshëm<sup>89</sup>.

Asnjë person nuk ka përgjegjësi penale, kur mungon lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit të tij si dhe mungon lidhja shkakësore e pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre. Asnjë person nuk mund të dënohet pa patur FAJ, për një veprim ose mosveprim të parashikuar me ligji si vepër penale, dmth që të ndëshkohet me ligj, duhet të ketë pasur faj. Kur personi që e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi llojaritet se ka FAJ. Një person që kryen veprë penale në gjendje të dehur, bartë përgjegjësi penale dhe nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësjia, kur deri te dehja është arritur nga rrethana të rastit dhe ka sjellë uljen e baraspeshës mendor, dhe sipas dispozitave ligjore, kjo rrethanë mund të merret si rrethnë

---

<sup>87</sup> Kodi penal i RSH-së, neni 4, [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.drejtesia.gov.al%2Fwp-content%2Fuploads%2F2017%2F11%2FKodi\\_Penal-1.pdf](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.drejtesia.gov.al%2Fwp-content%2Fuploads%2F2017%2F11%2FKodi_Penal-1.pdf)

<sup>88</sup> Kodi penal i RMV-së, neni 11

<sup>89</sup> Kodi penal i RMV-së, neni 12



lehtësuse për zbutjen e dënimit ndaj tij. Kur dehja është bërë me paramendim apo me vetëdije që ka pasur për qëllim të kryer veprën penale, kjo rrethanë mund ti llogaritet si rrethanë rënduse për në matjen e dënimit. Rregullat e njejta vlejné edhe te veprat penale që kryhet nën ndikimin e lëndëve narkotike. Një personi që bën tentativë për kryerje të një krimi, përgjigjet për të. Gjykata, në varësi të shkallës së afërsisë së pasojës, si dhe të shkaqeve për të cilat krimi mbeti në tentativë, zbut dënimin dhe mund ta ulë atë nën minimumin e parashikuar nga ligji ose të caktojë një lloj dënimi më të butë nga ai i parashikuar në ligj<sup>90</sup>.

---

<sup>90</sup> Zbutja e dënimit, neni 40 i Kodit penal të RMV-së

## KAPITULLI III

### Aspekte krahasimore të veprave penale të kryera në bashkëpunim dhe dënimet e bashkëkryerësve të veprave penale në praktiken gjyqësore me vendet fqinje

#### 1. Dënimet e bashkëkryerësve të veprave penale në praktikën gjyqësore në Kosovë

Kundërligjshmëria është element i përgjithshëm i çdo vepre penale. Ajo na paraqitet si bazë juridike për përcaktimin e veprës penale. Duke u nisur edhe analizuar natyrën e saj është tipar i çdo delikti, prandaj kundërligjshëria është tipar edhe i veprave penale. Nuk konsiderohet si vepër penale çdo vepër shoqërore e rrezikshme<sup>91</sup>. Lidhur me rrezikshmërinë si komponentë e kundërligjshmërisë, duhet theksuar se në të drejtën penale nuk konsiderohet vepër penale çdo vepër shoqërore e rrezikshme. Për t`u konsideruar një veprim i rrezikshëm si vepër penale, është e domosdoshme që ai veprim të manifestohet me një shkallë të lartë të rrezikshmërisë dhe të jetë i përcaktuar me ligj si vepër penale. Përkundër faktit se kundërligjshmëria është element i përgjithshëm dhe konstituiv i çdo vepre penale, kjo në të shumtën e rasteve nuk futet në përshkrimin ligjor të figurës së veprës penale. Kështu p.sh. në nenin 178 të KPRK nuk thuhet "kush e privon tjetrin nga jeta në mënyrë të kundërligjshme, ose psh në nenin 178<sup>92</sup>, nuk thuhet "kush e plagos tjetrin rëndë apo ia dëmton shëndetin rëndë në mënyrë të kundërligjshme, por vetëm thuhet kush tjetrin e privon nga jeta përkatësisht kush e plagos tjetrin rëndë apo ia dëmton rëndë shëndetin. Elementi i kundërligjshmërisë, si tipare e përgjithshme e çdo vepre penale, në të shumtën e rasteve nuk futet në figurën, në përshkrimin e figurës së veprës penale, nga se ekziston supozimi i përgjithshëm se çdo vepër penale është e kundërligjshme. Përmes këtij sesi prokurorët pjesëmarrës do të njoftohen lidhur me përgjegjësinë penale duke përfshirë elementet e përgjegjësisë penale. Sipas parimeve të së

---

<sup>91</sup> Republika e Kosovës Republika Kosova/Republic of Kosovo Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, mundësuar nga: <http://jus.igjk.rks-gov.net/727/1/Kodi%20Penal.pdf>

<sup>92</sup> Po aty

drejtës penale një person konsiderohet i përgjegjshëm atëherë kur posedon aso veti (cilësi) psikike që i bëjnë të mundshme të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet dhe veprimet e veta. Në të drejtën penale, një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka poseduar cilësi të caktuara psikike dhe nëse te ai ka ekzistuar një marrëdhënie e caktuar psikike ndaj veprës të cilën ai e ka kryer d.m.th. një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm. Përgjegjësia penale përbëhet prej dy elementeve:<sup>93</sup>

1. Nga vetitë e caktuara psikike të kryesit (përgjegjshmëria) dhe

2. Nga qëndrimi apo marrëdhënia e kryesit ndaj veprës që e ka kryer (fajësia).

Nga kjo rezulton se për të ekzistuar përgjegjësia penale, kryesi duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm – penalisht i përgjegjshëm. Një person konsiderohet i përgjegjshëm atëherë kur posedon aso veti (cilësi) psikike që i bëjnë të mundshme të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta. Ndërsa kryesi i veprës penale konsiderohet penalisht përgjegjës - i fajshëm, kur ndaj veprës ka pasur asi qëndrimi apo raporti i cili e bënë të mundshëm t'i ngarkohet vepra, përkatësisht kur veprën e konsideron si të veten. Nëse një person nuk është i përgjegjshëm, nuk është i aftë që ta kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e tija, atëherë nuk mund të konsiderohet i fajshëm, nga kjo rezulton se përgjegjshmëria është bazë ku ndërtohet fajësia, përgjegjshmëria është kusht për t'u sajuar fajësia. Në anën tjetër një person mund të jetë i përgjegjshëm por të mos jetë i fajshëm, nëse mungon njëri nga këto dy elemente nuk ka përgjegjësi penale. Në nenin 17. par. 1 të KPRK është përcaktuar nocioni i përgjegjësisë penale dhe në këtë paragraf thuhet "kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia." Në të drejtën penale një person mund të konsiderohet penalisht i përgjegjshëm vetëm atëherë kur ai person posedon veti të tilla mendore dhe volutive apo dashëse që i bëjnë të mundshme të mendojë e të gjykojë, të vendosë dhe t'i kontrollojë sjelljet dhe veprimet e veta. Prej këtij

---

<sup>93</sup> Republika e Kosovës Republika Kosova/Republic of Kosovo Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, mundësuar nga:  
<http://jus.igjk.rks-gov.net/727/1/Kodi%20Penal.pdf>

përkufizimi del se përgjegjshmëria përbëhet prej dy elementeve: elementit intelektual apo të vetëdijes dhe elementit volutiv apo të dëshirës-vullnetit Elementi intelektual (mendtor) apo i vetëdijes në të drejtën penale ekziston atëherë kur kryesi i veprës penale është i aftë që të kuptojë rëndësinë e veprës së vet, që të ketë pasqyrë, parafytyrim të qartë se është duke e kryer një vepër të rrezikshme dhe të kundërligjshme. Elementi volutiv apo elementi i dëshirës ekziston atëherë kur një personi është në gjendje apo ka aftësi mendore që të vendosë dhe t'i kontrollojë sjelljet e tij. Kodi Penal i Republikës së Kosovës<sup>94</sup>, sikur shumë kode penale të shteteve tjera nuk e përcakton nocionin e përgjegjshmërisë, por përkundrazi me nenin 18 paragrafi 1 përcakton papërgjegjshmërinë. Më parë u tha se personi është i përgjegjshëm kur posedon aftësi për ta kuptuar rëndësinë e veprës dhe aftësinë për t'i kontrolluar sjelljet e veta. Kryesi i veprës penale i cili nuk i posedon këto dy aftësi, apo njërën nga këto aftësi, në të drejtën penale konsiderohet i papërgjegjshëm. Sipas nenit 18 par. 1 të KPRK "Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet i paaftë mendërisht nëse në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga ndonjë sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, çrregullim mendtor apo ngecje në zhvillimin mendtor që e ka prekur funksionimin e tij mendtor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kuptojë apo kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij apo të kuptoj se kryen vepër penale". Sëmundjet mendore të përhershme dhe të përkohshme janë lloje të sëmundjeve të sistemit qendror nervor të intensitetit të tillë të cilat e bëjnë personin plotësisht të papërgjegjshëm, ndërsa sëmundjet mendore të përhershme apo kronike janë ato sëmundje që zgjasin kohë të gjatë dhe të cilat sipas të arriturave të shkencës së psikiatrisë bashkëkohore edhe përkundër mjekimit, janë të pashërueshme<sup>95</sup>. Si sëmundje psikike kronike janë psh. epilepsia, paraliza progresive, skizofrenia, paranoja, psikoza encefalike etj, ndërsa si sëmundjet mendore të përkohshme apo akute janë lloje të sëmundjeve që lajmërohen në perioda kohore dhe që spontanisht mund të pushojnë, apo të cilat sipas arritjeve bashkëkohore të shkencës së psikiatrisë mund të neutralizohen, madje edhe të shërohen<sup>96</sup>. Çrregullimi mendtor i përkohshëm është lloj i tillë i çrregullimeve mendore të përkohshme apo momentale të shumicës së

---

<sup>94</sup> Republika e Kosovës Republika Kosova/Republic of Kosovo Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, mundësuar nga: <http://jus.igjk.rks-gov.net/727/1/Kodi%20Penal.pdf>

<sup>95</sup> Kodi penal i R. së Kosovës

<sup>96</sup> Po aty

funksiioneve psikike posaçërisht të vetëdijes, e kur kryesi gjendet në aso gjendje shëndetësore që nuk është i aftë të gjykojë dhe të vendosë drejtë, nuk është në gjendje psikike që të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e tij, zhvillimi mendor me ngecje është gjendje e ngecjes së zhvillimit mendor (psikik), e cila është shkaktuar nga grymosja (atrofia) e sistemit qendror nervor, apo nga kushtet e posaçme sociale në të cilat ka jetuar një person<sup>97</sup>. Këtu bëhet fjalë për mos zhvillim të aparatit psikik, për shkak të cilit personi i këtillë nuk është në gjendje të gjykojë dhe të vendosë. Përgjegjshmëria esencialisht e zvogëluar është gjendje e tillë e personit në kohën e kryerjes së veprës penale, nëse për shkak të sëmundjes mendore kronike apo të përkohshme, çrregullimit mendor apo ngecjes në zhvillimin mendor, aftësia e kryesit që të kuptojë rëndësinë e veprës apo aftësia e tij që t'i kontrollojë sjelljet e veta ka qenë dukshëm, esencialisht e zvogëluar. Kodi ynë Penal njeh përgjegjshmërinë e zvogëluar, si gjendje psikike, mendore midis përgjegjshmërisë dhe papërgjegjshmërisë e paraparë në nenin 18 paragrafi 2 të KPRK<sup>98</sup>. Personi, i cili ka kryer vepër penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.” Në kuadrin e dashjes direkte shprehet në rastet kur kryesi është i vetëdijshëm, e di, ka parafytyrim të qartë për veprën që e kryen dhe pasojat që do të shkaktohen nga ajo vepër dhe për lidhjen kauzale midis veprës dhe pasojës që do të shkaktohet<sup>99</sup>. Te kjo formë e dashjes, kryesi duhet të jetë i vetëdijshëm edhe për tiparet e tjera që e përbëjnë figurën e veprës penale të caktuar, siç janë objekti i veprës penale, koha, mënyra, mjetet e kryerjes dhe të gjitha rrethanat tjera reale të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale. Nëse kryesi nuk ka qenë i vetëdijshëm për ndonjërin nga rrethanat reale që është tipare e veprës penale, atëherë te kryesi i tillë nuk ekziston dashja lidhur me atë vepër, p.sh. nëse personi A nuk di se akoma gjendet në martesë dhe lidhë martesë me personin B, atëherë nuk

---

<sup>97</sup> Kodi Penal i R. së Kosovës

<sup>98</sup> Republika e Kosovës Republika Kosova/Republic of Kosovo Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, mundësuar nga: <http://jus.igjk.rks-gov.net/727/1/Kodi%20Penal.pdf>

<sup>99</sup> Po aty

mund të konsiderohet se ka kryer vepër penale të bigamisë. Kodi Penal nuk bën dallime kur vepra penale kryhet me dashje direkte e kur me dashje eventuale Sipas KPRK, për veprat penale të kryera me dashje, kryesi gjithëherë përgjigjet penalisht, pa marrë parasysh se vepra penale është kryer me dashje direkte apo eventuale, madje kodi nuk bënë kurrfarë dallime parimore për veprat penale e kryera me këto dy forma të dashjes<sup>100</sup>. Mirëpo në teori dhe në praktikë, në të shumtën veprat penale të kryera me dashje direkte konsiderohen më të rënda se veprat penale të kryera me dashje eventuale. Në praktikën gjyqësore shpesh hasim dënime më të ashpra për dashje eventuale se sa për dashje direkte, mirëpo, në praktikën gjyqësore ndeshim edhe aso raste kur kryesi, i cili kryen vepër me dashje eventuale, për shkak të qëndrimit të tij, vrazhdësisë që manifestohet ndaj viktimës, është shumë më i rrezikshëm se personi që kryen veprën penale me dashje direkte, për këtë arsye meriton edhe ndëshkim më të rëndë<sup>101</sup>. Në shumicën e rasteve, si tipare të figurës së veprës penale, kodi penal nuk parasheh dashjen direkte apo eventuale me të cilat mund të kryhet vepra e caktuar, 64 Ligji p.sh. te vrasja thotë "kush tjetrin e privon nga jeta do të dënohet....," nga ky formulim rezulton se nuk përmend asnjë lloj dashje, me këtë është mbuluar edhe dashja direkte edhe ajo eventuale<sup>102</sup>.

---

<sup>100</sup> Republika e Kosovës Republika Kosova/Republic of Kosovo Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, mundësuar nga: <http://jus.igjk.rks-gov.net/727/1/Kodi%20Penal.pdf>

<sup>101</sup> Kodi penal i R. së Kosovës

<sup>102</sup> Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija / Dr.Sc. Fejzullah Hasani Komentari I KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, mundësuar nga: <http://jus.igjk.rks-gov.net/485/1/Komentari%20-%20Kodi%20Penal%20i%20Kosoves.pdf>

## 2.Dënimet e bashkëkryerësve të veprave penale në praktikën gjyqësore në Shqipëri

Në Republikën e Shqipërisë Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit (neni 24 i K.Pr.Penale<sup>103</sup> dhe neni 149 i Kushtetutes<sup>104</sup>). Sipas nenit 280 të K.Pr.Penale,<sup>105</sup> marrja dijani për veprën penale bëhet me iniciativën e vetë prokurorit ose me njoftim të bërë nga të tretët. Njoftimi bëhet nga nëpunësit publik, nga personeli mjekësor, nga shtetasit si dhe nga policia gjyqësore (nenet 281, 283, 283 dhe 293 i K.Pr.Penale). Policia gjyqësore, me marrjen njoftim për veprën penale, jo më vonë se 72 orë i referon prokurorit me shkrim elementët thelbësorë të veprës penale (neni 293 i K.Pr.Penale). Me fillimin e procedimit penal, prokurori udhëheq procedurën hetimore dhe kryen vetë çdo veprim që çmon të jetë i nevojshëm në atë procedurë. Ai kryhen hetime edhe për verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime (neni 304 i Kodit të Procedurës Penale)<sup>106</sup>. Ai mund të kërkojë nga policia gjyqësore kryerjen e veprimeve të deleguara posaçërisht duke përfshirë edhe marrjen në pyetje të të pandehurit si dhe ballafaqimet (neni 304 i K.Pr.Penale)<sup>107</sup>. Në nenet 288 dhe 289 janë reflektuar dispozitat kushtetuese për kufizimin e imunitetit të deputetit dhe procedurën e ndjekur në rastin e kërkimit të autorizimit nga Kuvendi për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, apo mundësinë e caktimit të një mase tjetër sigurimi pa nevojën e një autorizimi.

Pasi kryen veprimet e nevojshme hetimore, policia gjyqësore i dërgon aktet prokurorit bashkë me një relacion shpjegues për faktet dhe provat, si dhe me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve. Brenda afatit kohorë të hetimeve, prokurori njofton mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehurinj, mbrojtësin e tij, si dhe viktimën ose trashëgimtarët e tij,

---

<sup>103</sup> KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Dhjetor 2014

<sup>104</sup> KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Qendra e Botimeve Zyrtare Tiranë, 2017

<sup>105</sup> KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Dhjetor 2014

<sup>106</sup> KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Numër 7905 Datë Miratimi 30.03.2017 Datë e Hyrjes në Fuqi 01.08.2017

<sup>107</sup> KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Dhjetor 2014

kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, ku njoftimi përmban përshkrimin e përmbledhur të faktit penal për të cilin procedohet, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje<sup>108</sup>. I pandehuri njoftohet gjithashtu se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklaratime apo të kërkojë që të merret në pyetje.<sup>109</sup> Kur i pandehuri kërkon të pyetet, prokurori është i detyruar të procedojë me pyetjen e tij. Ky afat mund të zgjatet vetëm një herë dhe jo më shumë se dy muaj dhe në çdo rast pa kaluar afatin tërësor të hetimit. Kur nuk e pranon kërkesën e të pandehurit, prokurori merr vendim të arsyetuar, sipas paragrafit 2 të nenit 110 të këtij Kodi<sup>110</sup>. Në nenin 323<sup>111</sup> është parashikuar se brenda tre muajve nga data në të cilën emëri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori kërkon dërgimin e çështjes në gjyq ose vendos pushimin e saj. Periodha e zgjatjes së afatit është parashikuar gjashtë muaj në rastin e Prokurorisë së Posacme (neni 324); Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori procedon si më poshtë: a) vendos për pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 328, ose i kërkon gjykatës pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga neni 329/a i Kodit; b) i kërkon gjykatës dërgimin e çështjes në gjyq, kur nuk procedon sipas neneve 400, 406/a dhe 406/dh të këtij Kodi.<sup>112</sup> Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes<sup>113</sup>. Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesës së prokurorit i bashkëlidhen aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke

---

<sup>108</sup> <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.infocip.org%2Fal%2F%3Fp%3D6581>

<sup>109</sup> KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Numër 7905 Datë Miratimi 30.03.2017 Datë e Hyrjes në Fuqi 01.08.2017

<sup>110</sup> KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Dhjetor 2014

<sup>111</sup> Kodi i procedurës penale, neni 323

<sup>112</sup> KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Dhjetor 2014

<sup>113</sup> KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Numër 7905 Datë Miratimi 30.03.2017 Datë e Hyrjes në Fuqi 01.08.2017



përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër, ku më pas kërkesa i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim<sup>114</sup>, ata kanë të drejtë të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre. Brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës, gjykata njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, për datën dhe orën e gjykimit, e më pastaj kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve, mirëpo kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj<sup>115</sup>. Kur janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, gjykata vendos pushimin e akuzës ose çështjes, e në rast të kundërt, gjykata vendos sipas parashikimeve të shkronjës “b” ose “c”, të paragrafit 3, të nenit 329, të këtij Kodi, kur gjykata vendos sipas shkronjës “b”, të paragrafit 3, të nenit 329, të këtij Kodi, i cakton prokurorit një afat për kryerjen e hetimeve, e kur është rasti, zbatohen rregullat e parashikuara nga paragrafi 4, i nenit 329, të këtij Kodi<sup>116</sup>. Kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit. Zbatohen për aq sa janë të pajtueshme rregullat e përcaktuara në nenin 329 të këtij Kodi<sup>117</sup>.

### **3.Dënimet e bashkëkryerësve të veprave penale në praktikën gjyqësore në Kroaci**

Legjislacioni penal i Republikës së Kroacisë zbatohet për këdo që kryen një vepër penale në territorin e Republikës së Kroacisë<sup>118</sup>.

Llojet e bashkëkryerjes janë paraparë në nenet 36, 37 dhe 38 të Kodit Penal të Republikës së Kroacisë, kurse denimi i bashkëkryerësve është paraparë me nenin 39 të po të njejtit Kod<sup>119</sup>.

<sup>114</sup> Kodi i procedurës penale i R.së Shqipërisë, neni 329-a

<sup>115</sup> Kodi i procedurës penale i R.së Shqipërisë, neni 329-b

<sup>116</sup> KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Numër 7905 Datë Miratimi 30.03.2017 Datë e Hyrjes në Fuqi 01.08.2017

<sup>117</sup> KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Numër 7905 Datë Miratimi 30.03.2017 Datë e Hyrjes në Fuqi 01.08.2017

<sup>118</sup> [https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/1993\\_04\\_32\\_574.html](https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/1993_04_32_574.html), neni 2

Si ne kodin tonë, poashtu dhe në Kodin e R. së Kroacisë, ekzistojne tre lloje të bashkpunimit: bashkëkryerja, shtytja (nxitja) dhe ndihma.

Veprat penale dhe sanksionet penale parashkruhen vetëm për sjellje të tilla me të cilat liritë dhe të drejtat personale të njeriut si dhe të drejtat e tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Kroacisë dhe e drejta ndërkombëtare janë shkelur ose rrezikuar në atë mënyrë që të mos jetë e mundur të arrihet mbrojtje pa zbatim të ligjit penal. Askush nuk do të dënohet për ndonjë veprim që para kryerjes së tij nuk përbën vepër penale sipas të drejtës kombëtare apo ndërkombëtare dhe as nuk do të shqiptohet një dënim apo sanksion tjetër penalo-ligjor që nuk ka qenë i paraparë me ligj në kohën kur është kryer vepra penale. Mbi kryesin zbatohet ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Nëse ligji ndryshohet një ose më shumë herë pas kryerjes së veprës penale, por para nxjerrjes së aktgjykimit me fuqi të res judicata, zbatohet ligji më i butë për kryesin.<sup>120</sup>

Kur në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni ndryshohet emri ose përshkrimi i veprës penale, gjykata do të shqyrtojë nëse ka vazhdimësi juridike duke e nënshtruar gjendjen faktike në fjalë me përkufizimin ligjor të veprës përkatëse penale nga Kodi i ri. Kur konstaton se ekziston vazhdimësia ligjore, zbatohet Kodi që është më i butë në lidhje me autorin. Nuk ka vepër penale kur nuk ka vazhdimësi ligjore.

Nëse ligji ndryshohet gjatë kryerjes së veprës penale, do të zbatohet ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Ligji i paraparë të jetë në fuqi vetëm për një kohë të caktuar do të vazhdojë të zbatohet për veprat penale të kryera sa ka qenë në fuqi edhe pasi të ketë pushuar së ekzistuari.

Kodi Penal i Kroacisë veprën penale të vjedhjes e ka përcaktuar me nenin 228. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, *“Kushdo që merr sendin e luajtshëm prej një personi tjetër me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet”*. (Kodi Penal i Republikës së Kroacisë, 2011). Paragrafi 2 i nenit 228 të Kodit Penal të Kroacisë parasheh: *“Nese vlera e pasurisë së vjedhur është e vogël dhe kryesi ka vepruar me qëllim që atë vlerë të pasurisë*

---

<sup>119</sup> <https://www.zakon.hr/z/98/Kazneni-zakon>

<sup>120</sup> Criminal Code, Class: 011-01/11-01/186 No.: 71-05-03/1-11-2 Zagreb, 26 October 2011

*ta përvetësojë, ai ose ajo do të dënohet me burgim jo më shumë se një vit.”* (Kodi Penal i Republikës së Kroacisë, 2011).<sup>121</sup>

Nga kjo mund të konkludojmë se sikurse Kosova edhe vendet e tjera të rajonit Shqipëria, Maqedonia, Serbia e Kroacia e kanë paraparë veprën penale të vjedhjes me kodet e tyre penale. Në parim, përcaktimi i kësaj vepre penale nuk ka ndonjë dallim esencial për nga kualifikimi apo inkriminimi i veprës penale të vjedhjes. Megjithatë, mund të vërejmë disa dallime sic është rasti me sanksionin penal. Përderisa sanksioni penal sipas kodeve penale të Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë dhe Kroacisë është paraparë me gjobë si dhe me burgim dy, respektivisht tri vjet, sipas Kodit Penal të Kosovës dënimi për këtë vepër penale është araparë me gjobë ose me burgim deri në tri vjet. Neni 228 i Kodit Penal të Kroacisë ka disa karakteristika që nuk i kanë Kodet Penale të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë, ku në paragrafin 3 të nenit 228 të Kodit Penal të Kroacisë theksohet se: *“Nese kyysi i veprës penale ia kthen pasurinë e vjedhur palës së dëmtuar para se të ketë mësuar se ai ose ajo është zbuluar, dënimi i tij ose i saj mund të zvogëlohet ose falet”* (Kodi Penal i Republikës së Kroacisë, 2011)<sup>122</sup>. Kjo është një nga karakteristikat e Kodit Penal të Kroacisë që e bëjnë të dallueshëm nominimin e veprës penale të vjedhjes në krahasim me Kodin Penal të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë, e që vlen edhe për bashkëkryesir e veprave penale sepse.

---

<sup>121</sup> Criminal Code, Class: 011-01/11-01/186 No.: 71-05-03/1-11-2 Zagreb, 26 October 2011

<sup>122</sup> Po aty

## KAPITULLI IV

### Studim empirik

#### Të dhëna nga Gjykata themelore në Gostivar për aktgjykimet e krimeve të ndryshme të kryera në bashkëkryerje

##### Vëllimi dhe dinamika e veprave penale të ndryshme të kryera në bashkëkryerje

<b>Veprave penale të ndryshme të kryera në bashkëkryerje</b>	<b>Gjithëse j: 53 lëndë</b>	<b>Aktgjykim m lirues</b>	<b>Aktgjykim refuzues</b>	<b>Aktgjykim m dënues</b>
Neni 325	Lëndët e shqyrtuara	2 (dy)	1 (një)	50 (pesëdhjetë)

Veprimet përgatitore janë ato të cilat kryesit i ndërmarrin me qëllim të krijimit të kushteve më të përshtatshme për kryerjen e veprës penale. Këto veprime konsistojnë në planifikimin për të kryer veprën, aftësimin e mjeteve që do të përdorën për kryerje si dhe organizimin me persona tjerë. Mbështetur në lëndët e shqyrtuara në Gjykatën themelore në Gostivar, nuk shihet ndonjë përgatitje e vecantë që është bërë nga ana e kryesit por megjithatë ka pasur raste kur kanë qenë të pranishme edhe këto veprime. Zakonisht këto janë të shprehura tek rastet e bashkëkryerjes nga dy e më tepër persona të cilët paraprakisht janë marrë vesh në mes vet për vendin, kohën, mjetet që do t'i marrin me vete. Nga lëndet e studiuara kam hasur në 2 raste ku kryesit paraprakisht ishin marrë për të kryer vjedhjen, pastaj i

kishin ndarë në mes vete detyrat ku njëri kishte marrë përsipër ta sjell një veturë, tjetri të hyjë në objektin për të kryer veprën penale dhe dy të tjerë të bëjnë roje derisa do të kryhej vjedhja. Deri te tentativa vjen atëherë kur kryesi i ndërmerr të gjitha veprimet për të kryer veprën penale por nuk ia arrin për të bërë një gjë të tillë. Gjatë hulumtimit të lëndëve penale të vjedhjes në Gjykatën themelore në Gostivar kam hasur në 3 raste të tentativës për të kryer veprën penale. Deri te kapja e këtyre personave që po tentonin të kryenin veprën penale të vjedhjes ka ardhur si rezultat i punës së policisë të cilit pas informacionit që kanë marrë nga qytetarët dhe si rezultat i patrollimeve të vazhdueshme që bëjnë në këtë regjion ia kanë dalur që t'i arrestojnë Gjykatën themelore në Gostivar.

Përcaktimi i vendit të kryerjes së veprës penale luan një rol shumë të rëndësishëm sepse nga kjo varet edhe përcaktimi i kompetencës së gjykatës për t'u marrë me rastin konkret. Si vend i kryerjes së veprës penale konsiderohet vendi ku është kryer vepra si dhe vendi ku është shkaktuar pasoja. Rol të rëndësishëm në zbulimin e veprës penale luan edhe këqyrja e vendit të ngjarjes. Përmes këqyrjes së vendit të ngjarjes, ekipi i caktuar i organit kompetent përcakton mjetin me të cilin është kryer vepra, vendin ku është kryer, rrugën nga ka shkuar kryesi, numrin e pjesëmarrësve si dhe identifikimin e tyre. Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes bëhen fotografime, skicime si dhe mbahet procesverbal në të cilin shënohen edhe gjurmët të cilët janë gjetur në vendin e ngjarjes.

Gjatë hulumtimit të lëndëve penale të vjedhjes kam parë se është bërë punë shumë efektive nga pjesëtarët e policisë të cilët kanë shkuar në vendin e ngjarjes dhe kanë gjetur mjete të ndryshme të cilat kryesisht i kanë përdorur për kryerjen e veprës penale të vjedhjes si: dorëzat, maska, shufra metalike, armë të ftohta etj. Të gjitha këto janë fotografuar dhe konfiskuar dhe më vonë i kanë shërbyer gjykatës për ta provuar fajësinë e kryesve. Rëndësi të vecantë për këqyrje dhe identifikim kanë pasur veprimet para fillimit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, siç kanë qenë përcaktimi nëse ka vend për fillimin e çështjes penale, përcaktimi mbi formimin e grupit të hetimit – këqyrjes në vend të ngjarjes, si dhe marrja e masave për këqyrjen e vendit të ngjarjes. Bashkëkryerja ekziston atëherë kur dy apo më tepër persona marrin pjesë në kryerjen e veprës penale. Që një person të konsiderohet si bashkëkryes nuk mjafton vetëm pjesëmarrja e tij por duhet që ai të shkaktoj pasojë në botën e jashtme. Kodi Penal i Kosovës e ka paraparë

bashkëkryerjen në nenin 31 ku thuhet se: *“bashkëkryerja ekziston atëherë kur dy e më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale ose thelbësisht duke i ndihmuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër dhe secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet për veprën penale”*. Tek bashkëkryerja nuk mjafton që personi vetëm të ketë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale por nevojitet edhe një marrëveshje paraprake në mes tyre për të kryer këtë veprë. P.sh nëse dy kryes rastësisht janë takuar në një vend dhe kanë kryer vjedhje secili për vete, atëherë kemi të bëjmë me bashkëkryerje. Kryesit e veprës penale kanë marrë pjesë si bashkëkryes në 9 raste ku në cilësinë e bashkëkryesve në shumicën e rasteve janë paraqitur familjarët. Përveç bashkëkryerjes si formë tjetër e bashkëpunimit është edhe ndihma. Ndhima në Kodin Penal të RMV-s është paraparë në nenin 33 ku thuhet se: *“ndihma për të kryer një veprën penale përfshin këshillimin apo udhëzimin se si kryhet vepra penale, duke vënë në dispozicion të kryesit mjetet për kryerjen e veprës, duke larguar pengesat ose duke i premtuar paraprakisht se do t'i fsheh provat e veprës penale, identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kjo veprë”*. Edhe tek ndihma sikurse tek bashkëkryerja në cilësinë e ndihmësit në shumicën e rasteve janë paraqitur anëtarët e familjes p.sh babai ka ndihmuar të birin rreth kryerjes së veprës apo i biri babain. Pastaj në disa raste gjykata ka konstatuar se në cilësinë e shtytësit dhe ndihmësit janë paraqitur edhe të afërmit e tjerë që i kanë nxitur që të kryejnë veprën penale dhe t'ua dhurojnë atyre, duke siguruar kështu përfitime të konsiderueshme.

Grafiku 1. Mosha e kryesve

Recidivizmi paraqet një formë të vecantë dhe të rrezikshme të kriminalitetit.

Kryesit e veprave penale që janë recidivist, konsiderohen si persona më të rrezikshëm. Kjo, dukuri ka të bëjë me persosshmërinë e tyre sepse këta duke përsëritur dy apo më tepër herë veprën penale shndërrohen në kryes profesionist. Pra, nga këtu vijmë dhe te definicioni i recidivistëve që mund të definohen si persona që të njejtën vepër e kryejnë dy apo më tepër herë. Recidivizmit i kushtohet një rëndësi e kosiderueshme si në teorinë juridiko- penale ashtu edhe në trajtimin e çështjeve penale para gjykatës. Recidivizmi është rrethanë rënduese dhe ndikon që gjykata të shqiptoj dënim më të rëndë ndaj recidivistëve. Nga të dhënat e marra nga Gjykata Themelore Gostivardel se numri i recidivistëve tek vepra penale e nw bashkepunim është shumë i pranishëm. (Aktgjykimet e Gjykses themelore Gostivar, 2015- 2018). Kjo për faktin se të gjithë kryesit janë njerëz të papunë dhe me kushte të vështira ekonomike dhe përkundër faktit se ata dënohen me gjobë e dhe me burgim ata e përsërisin veprën penale dy e më tepër herë. Me qëllim që t'i bëjë një studim sa më të mirë recidivizmit dhe shkaqeve që e nxisin atë kam shkuar dhe kam vizituar disa fshatra ku vjedhja është shumë e pranishme. Aty kam pas rastin të bisedoj me fshatar të cilët e kanë pranuar se kryejnë vjedhje dhe se ndjejnë keqardhje për dëmet që shkaktojnë me veprime të tilla. Mirëpo sipas tyre e vetmja shpresë për mbijetesë në këto zona është vjedhja. Edhe përkundër faktit se kanë marrë dënime për veprën e kryer, ata nuk e kanë ndërmend të heqin dorë nga vjedhjet derisa shteti të mendoj për ta dhe të investojë në këto zona që në mënyrë që këta njerëz të gjejnë ndonjë vend

pune.

## GJINIA

Gjinia e kryesve është poashtu një karakteristikë tjetër e fenomenit kriminal. Edhe pse krimi në të shumtën e rasteve trajtohet si dukuri tipike mashkullore megjithatë ka raste kur edhe femra paraqiten si kryese të veprave penale. Gjatë hulumtimit të lëndeve penale të nw bashkepunim kam arritur të konstatoj se të gjithë kryesit e kësaj vepre penale kanë qenë të gjinisë mashkullore. Pra femrat nuk kanë marr pjesë me asnjë përqindje në kryerjen e kësaj vepre që po e trajtojmë në këtë punim. (Aktgjykimet e Gjykes themelore Gostivar, 2015-2020). Ajo çfarë e bënë këtë dukuri tipike mashkullore konsideroj se qëndron në faktin se në viset rurale meshkujt janë të obliguar që të kujdesen për mbajtjen e familjes dhe është normale që janë paraqitur edhe si kryes te veprës penale të kryera në bashkepunim. Femrat në këto regjione merren më tepër me punët e shtëpisë dhe përkujdesen ndaj fëmijëve. Gjithashtu edhe marrja me këtë veprimtari kërkon edhe fuqi fizike të cilën femrat nuk e posedojnë madje këtë më së miri e elaborojnë edhe disa autorë të cilët pjesëmarrjen e vogël të femrës në kriminalitet e arsyetojnë me faktin se femra është më e dobët në pikëpamje anatomike-fizike.

Kryesit e veprës penale të në bashkepunim në territorin e Gjykata themelore Gostivar kanë qenë në kushte shumë të dobta sociale. Vlen të theksohet se shumica e kryesve të këtyre veprave penale janë të papunë, jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe nga të hollat që i fitojnë përmes veprimeve të kunderligjshme përpiqen ta mbajnë familjen. Mbështetur në lëndët penale të studiuara del se vepra penale vjedhje i ka rrënjët pikërisht në kushtet e vështira ekonomike. Madje shumica prej kryesve u përkasin familjeve shumë anëtarëshe ku kanë edhe rolin e kryefamiljarëve. Në kryerjen e veprës penale vjedhje përveç shqiptarëve kanë marrë pjesë edhe pjesëtarë të komunitetit serb edhe pse numri i tyre është më i vogël. Përveç në cilësinë e kryesve, pjesëtarët e këtij komuniteti në disa raste janë paraqitur edhe si shtytës, ndihmës dhe bashkëkryes. Vjedhjet nga pjesëtarët e komunitetit serb janë kryer kryesisht në fshatrat: Banjë, Syrganë etj. (Aktgjykimet e Gjykes themelore Gostivar, 2015-2020).



## **Faktorët ekonomik social me ndikim në kryerjen e veprës penale të në bashkepunim**

Në formimin dhe zhvillimin e personalitetit luajnë rol shumë faktorë. Një ndër këta faktorë janë edhe ata ekonomik-socialë. Kur kryhet një vepër penale zakonisht mendohet në vetitë e brendshme të kryesit. Mirëpo duhet pasur parasysh çdoherë edhe faktorë të tjerë të mundshëm të cilët mund të sjellin deri tek vepra penale. Gjatë shqyrtimit të lëndëve penale të kryera në bashkepunim në territorin e Gjykata themelore Gostivar kam arritur të kuptoj se kryerjen e kësaj vepre e kanë determinuar edhe disa faktorë të jashtëm. Një ndër këta faktorë është edhe kriza ekonomike.

### **Kriza ekonomike**

Gjendja e vështirë ekonomike është shkaktar kryesor dhe numër një që i detyron njerëzit ta shkelin ligjin dhe kështu t'i mbajnë familjet e tyre nga paratë e fituara me veprën penale të kryera në bashkepunim në mënyrë ilegale.

### **Varfëria**

Si rezultat i krizës ekonomike vjen edhe deri tek varfërimi i njerëzve. Edhe varfëria konsiderohet si një faktor objektiv me ndikim në kriminalitet. Gjatë studimit që u kam bërë lëndëve penale të kryera në bashkëpunim kam konstatuar se ndikim të madh në kryerjen e kësaj vepre ka pasur edhe varfëria. (Aktgjykimet e Gjykates themelore Gostivar, 2015-2020). Vepra penale vjedhje është produkt i shtresave të varfëra të komunave më popullsi më të varfer, kurse shtresa me kushte më të mira ekonomike është shumë pak e pranishme në kryerjen e kësaj vepre.

### **Kushtet e vështira materiale për jetesë**

Pos faktorëve të përmendur edhe kushtet e vështira për jetesë, si faktorë ekonomik socialë, ndikojnë në kryerjen e veprës penale vjedhje. Gjatë hulumtimit dhe pergaditjes së këtij punimi, kamardhur në përfundim se numri më i madh i kryesve të veprave penale te kanë pasur kushte të vështira që nuk i kanë plotësuar as kushtet elementare për banim.

Prej 100 kryesve të veprave penale të ndryshme të hulumtuara, 64 prej tyre jetojnë në kushte shumë të rënda për banim, e duhet cekur më saktë që uk i kanë plotësuar as kushtet elementare.

Shtëpitë e tyre janë të vjetra, shumicën e rasteve njëkatshe, me mure të çara e me çati të shkatërruara ku gjatë kohës së dimrit dhe kur bie shi ata kanë probleme serioze. Më pas sa i përket higjienës, ata nuk i kishin as kushtet minimale higjenike, ku shumica prej tyre nuk kanë as ujë nëpër shtëpitë e tyre dhe detyrohen që ujin ta sigurojnë duke bartur.

### **Të dhëna nga Gjykata themelore në Gostivar e Tetovë për aktgjykimet e krimeve të ndryshme për dënimet e shqiptuara ndaj bashkëkryerësit**

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe të gjithëve iu takon, pa asnjëfarë diskriminimi, mbrojtje e barabartë me ligj (neni 7 nga Deklarata Univerzale për të drejtat e njeriut).<sup>123</sup>

Në këtë kontekst ,ligji duhet të ndalojë çdo lloj diskriminimi dhe t'u sigurojë të gjithë personave mbrojtje të barabartë dhe të sukseshme kundër çdo lloj të diskriminimi, e veçanërisht mbi baza racore, të ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, përcaktimit politik, prejardhjes nacionale apo sociale, gjendjes pronësore, lindjes apo çdo baze tjetër (neni 26 nga Pakti Ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike)<sup>124</sup>.

Për realizimin e parimeve të lartëpërmendura, në ligjet për procedura gjyqësore janë paraparë norma përmes të cilave mund të sigurohet realizimi i tyre. Qytetarët para Kushtetutës dhe Ligjeve janë të barabartë (neni 9, paragrafi 2 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë). Kjo normë e Kushtetutës është konkretizuar në Ligjin për Gjykatat<sup>125</sup>.

Në ligji për Gjykatat e konkretisht ne nenin 6, janë paraparë disa parime, e të cilat janë: çdokush ka të drejtë për qasje të barabartë para gjykatës gjatë mbrojtjes të së drejtave dhe interesave që kanë mbështetje ligjore; çdokush ka të drejtë për gjykim ligjor, të paanshëm, të ndershëm dhe në afat të

---

<sup>123</sup> Konventa mbi të drejtat e fëmijës Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

<sup>124</sup>International Covenant on Civil and Political Rights Office of the United Nations High Commissioner of Human Rights

<sup>125</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, mundësuar nga: <https://sobranie.mk/content/ustav%20al/ustav%20rsm-al-ok.pdf>

arsyeshëm; askujt nuk guxon t'i kufizohet qasja ndaj gjykatës për shkak të mungesës së mjeteve materiale. Parimet e lartpërmendura paraqesin standarde të parapara në dokumentet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe paraqesin pjesë përbërëse të Ligjit të kujdestarise tonë.<sup>126</sup>

**Tabela nr.1 Rastet të kryera nga të miturit me vendime përfundimtare nga Gjykata Themelore e Gostivar viti 2015**

Nënshtrimi i lëndëve - llojet e rasteve të kryera gjatë vitit 2015	Numri i rasteve
Grabitje	1
Rast i kryer kundër sigurisë së njerëzve dhe shtëpisë	3
Përkeqësim të sigurisë së lëvizjes në qytet	10
Vjedhje e rëndë	18
Dhunë mbi të miturin i cili nuk ka mbushur 14vj	1
Ndalim të votave dhe zgjedhjeve	1
Rast i kryer me lëndë narkotike, drogë etj.	1
Dhunë seksuale	2
Dhunë	1
Pjesmarrje në rrahje fizike	1
Lëndime të rënda trupore	1

<sup>126</sup> Kështu sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive elementare, garancioni për barazi përfshin më shumë apskete: Të drejtën e barazisë para ligjit Të drejtën e barazisë para gjykatave Të drejtën e qasjes së barabartë nëpër gjykata Të drejtën e trajtimit të barabartë para gjykatave

Sipas kësaj tabele mund të vërehet në Gjykatën e Gostivar janë paraqitur kryesisht 30 raste gjatë vitit 2015.

**Tabela nr.2 Rastet të kryera nga të miturit me vendime përfundimtare nga Gjykata Themelore e Gostivar viti 2016**

Nënshtrimi i lëndëve - llojet e rasteve të kryera gjatë vitit 2016	Numri i rasteve
Pjesmarrje në përleshje	2
Vjedhje	12
Trafikim me armë	3
Vjedhje e rëndë	26
Përkeqësim të sigurisë së lëvizjes në qytet	4
Prishje e sendve të huaja	1
Lëndim i rëndë trupor	3
Dhunë seksuale	1
Lëndime trupore	4
Vrasje	2
Mundësim të shfrytëzimit të lëndëve narkotike	1
Dëshmi e rejtshme për vepër penale	1

Sipas kësaj tabele mund të vërehet në gjykatën e Gostivar janë paraqitur kryesisht 60 raste gjatë vitit 2009. Pra kemi dyfishim të rasteve krahasuar nga viti 2016.

**Tabela nr.3 Rastet të kryera nga të miturit me vendime përfundimtare nga Gjykata Themelore e Gostivar viti 2017**

Nënshtrimi i lëndëve - llojet e rasteve të kryera gjatë vitit 2017	Numri i rasteve
Përkeqësim të sigurisë së lëvizjes në qytet	3
Vjedhje e rëndë	22
Lëndim i rëndë trupor	3
Armbajtje pa leje dhe trafikimi armësh	3
Realizim të skicave dhe vizatimeve	1
Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm	1
Kërcnim	1
Vrasje	3
Rast i kryer kundër sigurisë së njerëzve dhe shtëpisë	1
Dhunë	3
Shkaktim të acarimit fetar	1
Mbështetje në krim	2

Pjesmarrje në rrahje	1
----------------------	---

Sipas kësaj tabele kemi 44 raste të paraqitura në Gjykatën e Gostivar.

**Tabela nr.4 Rastet të kryera nga të miturit me vendime përfundimtare nga Gjykata Themelore e Gostivar viti 2018**

Nënshtrimi i lëndëve - llojet e rasteve të kryera gjatë vitit 2018	Numri i rasteve
Armëbajtje pa leje dhe trafikimim të tyre	2
Vjedhje e rëndë	20
Marrje e automjetit	1
Përkeqësim të sigurisë së lëvizjes në qytet	6
Vjedhje	5
Mbështetje në krim	1
Rast i kryer kundër sigurisë së njerëzve dhe	3

shtëpisë	
Shkaktim të acarimit fetar	2
Vrasje	1
Dhunë	1
Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm	1
Grabitje	1
Ndalesë të kryerjes së detyrës	1
Lëndim trupor	1

Sipas kësaj tablele kemi 46 raste të paraqitura në Gjykatën themelore të Gostivar gjatë vitit 2018.

**Tabela nr.4 Rastet të kryera nga të miturit me vendime përfundimtare nga Gjykata Themelore e Gostivar viti 2019**

Nënshtrimi i lëndëve - llojet e rasteve të kryera gjatë vitit 2019	Numri i rasteve
Lëndime të rënda trupore	3
Përkeqësim të sigurisë së lëvizjes në qytet	4
Vjedhje e rëndë	17
Vjedhje	8
Përdorim të lëndëve narkotike	4
Shkaktim të përleshjes	1
Sulm ndaj personit që nuk ka mbushur ende 14 vj	2
Lëndime trupore	4
Dhunë	1
Kërcnim	1
Përdhunim	3
Grabitje	1
Marrje të automjetit	1
Kryerje e dashurisë mbi njeriun e paaftë	1



Sipas kësaj tabele vërejmë se kemi 51 raste në vitin 2019 të paraqitur në gjykatën themelore të Gostivar. Viti 2019 në krahasim me vitet tjera rënditet i dyti për nga nr i rasteve

Gjatë punës hulumtuese shfrytëzimi i metodës deduktive do të mbështetet në përdorimin e bibliografisë primare për të dhënë dhe analizuar konkluzionet përfundimtare. I gjithë hulumtimi do të mbështetet në shfrytëzimin e metodës së studimit të rasteve individuale e cila metodë do të mbështetet në studimin e rasteve specifike që kam arritur ti analizojë nga vendimet e marrura nga Gjykata Themelore e Gostivarit vendime të cilët janë shqiptuar nga ana e gjykatësve ndaj të miturëve.

Përdorimi i këtyre metodave është i dobishëm për cilësi të larta shkencore, për rrugën e hulumtimit, për gjurmimin e rasteve specifike që kam hasur ti shoh për së afërmi nga ana e fakteve që përfshiheshin nga lëndët me vendime të marrura me një epilog përfundimtarë dhe njëkohësisht të bëjë pasqyrimin e rezultateve të hulumtimeve mbi deliktet e kryera nga ana e të miturëve.

Në këtë hulumtim kemi marrë parasysh lëndë, aktgjykime dhe delikte me të miturit. Nga Gjykatat themelore e Gostovarit kemi siguruar 4 raste ku vendimi nga aktgjykimi ka qënë marrja e masës disiplinore. Po ashtu kemi 2 raste ku vendimi i aktgjykimit ka qënë mbikqyrja nga ana e qendrës dhe 6 raste ku aktgjykimi ka qënë mbikqyrja nga ana e kujdestarit ose prindërëve. Prej të gjithëve këtyre aktgjykimeve do të marrim nga një rast.

#### **Aktgjykimi KM.nr 46/11**

Sipas gjykatës themelore të Gostivar, vendimi i marrë nga po kjo gjykatë kundrejt M.M i lindur në vitin 1993 nga fshati Odri mbi të njejtin merret masë disiplinore, mbikqyrje nga ana e kujdestarit ose nga ana e prindërëve.

Sipas këtij vendimi vërejmë se i akuzuar M.M nga fshati Odri ka përdore lëndë narkotike, drogë vepër e cila është në kundërshtim me nenin 216 paragrafi 1 nga Kodit Penal.

#### **Aktgjykimi KM.nr 17/12**

Sipas gjykatës themelore në Tetovë, kundrejt të miturit S.P është marrë masë e mbikqyrjes së rëndë nga ana e prindërve ose kujdestarit. Kundrejt prindërve është marrë masë që të edukojnë të miturin dhe të hjekin të gjitha ndikimet e këqija që i posedon ai.

Djalin në fjalë ka prekur në pasurinë e tjetrit ka marrë rreth 11 mi euro ai betohet së më këtë nuk do të bëjë asjëherë. Më një fjalë ai ka realizuar një vjedhje të rëndë, të cilë e ka kryer në bashkpunim.



## PËRFUNDIMI

Nga praktika e hetimit dhe e gjykimit të veprave penale të kryera në bashkëpunim, janë evidentuar një sërë problemesh.

Të gjitha këto probleme gjatë këtij hulumtimi duke shfrytëzuar metoda, teknika e taktika të ndryshme nga praktika gjyqësore e Gjykatës themelore në Gostivar, e gjithashtu nga ajo e Apelit poashtu në Gostivar, e në krahasim me vendimet e Gjykatave të shteteve fqinje të RMV-së, si ato të R. së Kosovës, Shqipërisë, Kroacisë e Sërbisë, arrijmë në një përfundim të suksesshëm të këtij hulumtimi, më saktë teze të magjistraturës, duke shqyrtuar problemet, përparësitë e mangësitë gjatë procedurës, si asaj hetimore e poashtu edhe gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore nga të gjitha llojet e veprave penale të kryera në bashkëpunim e deri te shqiptimi i dënimit ndaj bashkëkryerësve.

E gjithë kjo, më saktë, i gjithë ky hulumtim në lidhje me temën; *“Dënimi i bashkëkryerësve të veprave penale në praktiken gjyqësore të Gjykatës Themelore në Gostivar (2015-2020)”*, u realizua nga analiza të hollësishme e nga përvoja të ndryshme, nga literatura adekuate, ligjet e kodet, konventat ndërkombëtare, burime nga interneti e nga hulumtime të shumta shkencore, duke arritur në përfundime (konkluzione), të bazuara.

Rëndësia dhe arsyet e hulumtimit të këtij punimi janë të shumta por njëra ndër më të rëndësishmet është ajo, se ky punim është një lloj ndihmese për të kuptuar në mënyrë të detajuar institutin e Fajit, format e manifestimit të tij dhe rëndësinë e këtyre formave në jurisprudencën penale. Pra, realizimit të këtij punimi do t'i shërbej hartimi i një strukture funksionale të brendshme të të gjitha strukturave shtetërore në veçanti Prokurorisë shtetërore dhe Gjysqisë lidhur me identifikimin rast pas rasti të elementeve përbërës të veprës penale kryesit Fajit me qëllim ndihmese për të bërë dallimin e qartë ndërmjet veprave penale dhe mbi bazën e të cilave do të akuzohet autori i saj. Sa më i bazuar do të jetë procesi gjyqësor i përcaktimit të fajit, aq më ligjore do të jetë veprimtaria e organeve të procedimit penal dhe të drejtësisë penale në vazhdimin e veprimeve të mëtejshme. Pra, punimi në fakt në mënyrë modeste do të ketë impakt në modernizimin e legjislacionit tonë penal, posaçërisht në pjesën e anës subjektive të figurës së veprës penale, por edhe të procedurës penale. Në këtë pjesë, Kodi ynë Penal, ka nevojë për

reformim, sipas parimeve të përgjithëshme juridike-penale, për tu përsosur dhe për tu afruar më shumë me qëndrimet bashkëkohore të së Drejtës Penale si dhe me praktikën europiane përkatëse. Kështu Kodi ynë Penal ka nevojë të plotësohet me dispozita sqaruese, ndërsa ai procedural me reformën e Gjykatës së Krimeve të Rënda.

*Së fundi*, ky hulumtim do të gjallëronte më shumë jetën juridike penale në vëndin tone pasiqë, zgjerimi i botimeve në këtë fushë, do të perbënin kontribut të çmuar në përpunimin e mendimit shkencor juridik penal dhe forcimin e formimit shkencor profesional të studentëve të drejtësisë të universiteteve në vëndin tonë. Punimi i kësaj teze ndoshta do të jetë sadopak i ndikueshëm edhe tek ligjvënësi për të pasuruar dispozitat në legjislacionin penal që kanë të bëjnë me kualifikimin e veprave penale në procedurat gjyqsore si dhe plotësimin e zbrastirave juridike që mund të hasen në legjislacionin vendas. Me rastin e hulumtimit dhe të vërtetimit të hipotezave të lartpërendura dhe pas arritjes dhe realizimit të qëllimeve të parapara në këtë punim do të rezultojnë disa përfundime dhe rekomandime që u nxorën nga ky hulumtim. Për dënimin e kryerit të veprës penale nuk mjafton sjellja e kryerësit të përgjigjet me përshkrimin ligjor të veprës penale dhe të jetë kundërligjore dhe e rrezikshme, nëse për sjelljen nuk ka faj (fajësi). Vepra penale mund të kryhet nga një apo më shumë persona. Nëse vepra penale kryhet nga dy apo më shumë persona, përbën rrezikshmëri më të lartë shoqërore. Kur vepra penale kryhet nga dy apo më shumë persona, para së drejtës penale dhe praktikës gjyqsore shtrohet problemi i përcaktimit të rolit dhe kontributit të secilit bashkëpunues në kryerjen e veprës penale. Politika ndëshkimore konsiston në aplikimin e dënimeve si dhe sanksioneve tjera penale ndaj atyre që kryejnë vepra penale me qëllim të luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit në shoqëri. Luftimin e kriminalitetit e kanë si prioritet të gjitha shoqëritë e gjithashtu edhe shoqëria jonë. Duhet pasur parasysh se kriminaliteti nuk mund të luftohet me mjete e metoda të njehta, këto mjete e metoda duhet të avancohen çdo ditë sepse kriminaliteti është një dukuri komplekse dhe kërkon një qasje më serioze. Për dallim nga e kaluara ku politika e luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit ishte e mbështetur kryesisht në dënime, tani në shoqërinë bashkëkohore politika e luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit kërkohet që të mbështetet në masat preventive. Mirëpo fatkeqësisht në shoqërinë tonë si mjete kryesore për luftimin e kriminalitetit akoma kanë mbetur masat represive.

Masat represive që aplikohen ndaj kryesve të veprave penale kanë për qëllim luftimin e këtyre veprave, mirëpo është e rëndësishme që këto të mos jenë masat e vetme që ndërmerr shteti. Shoqëria duhet të bëjë përpjekje që të gjejë mënyra të tjera për parandalimin e kriminalitetit duke hulumtuar shkaqet dhe faktorët që shpiejnë në kryerjen e veprës penale. (Udhëzues për politikën ndëshkimore, 2018).

Gjatë hulumtimit të bërë lidhur me veprën penale të kryera në bashkepunim kam parë që Gjykata themelore në Gostivar ka një politikë ndëshkimore puthuajse të njëjtë ndaj kryesve të veprës penale në bashkepunim. (Aktgjykimet e Gjykeses themelore Gostivar, 2015-2020). Pra nuk shihet të jetë bërë ndonjë studim i vecantë i karakteristikave për secilin kryes, e siç dihet kjo është shumë e rëndësishme me rastin e shqiptimit të dënimit nga gjykata. Këtë po e potencojmë për faktin se edhe pse është fjala për kryes që kanë kryer vepër penale të llojit të njëjtë megjithatë ka dallime në mes tyre. Politika ndëshkimore që ka aplikuar gjykata në themelore në Gostivar nuk shihet të ketë dhënë ndonjë rezultat pozitiv sa i përket parandalimit të veprës penale të kryer në bashkepunim. Se kjo politikë ka qenë e pasuksesshme tregon fakti se shumë nga këta kryes janë shëndërruar në recidivist. Disa prej tyre gjykata i ka dënuar me dy e më tepër herë, por ka edhe shumë të tjerë për të cilët organet kompetente për luftimin e kriminalitetit nuk ja kanë dalur t'i kapin për përsëritje të veprës penale.

Një kontribut negativ në shëndërrimin e këtyre kryesve në recidivist mendoj se po jep edhe vet gjykata duke i trajtuar këto vepra si të lehta dhe jo të një rëndësie të posaçme. Mirëpo konsideroj se kjo qasje duhet mënjanuar sepse pasuria e të gjithë neve është me rëndësi shumë të madhe andaj edhe lufta ndaj atyre që i shkatërrojnë gjërat me vlerë duhet të jetë serioze.

Ajo çfarë kam vërejtur lidhur me politikën ndëshkimore në Gjykatën e Gostivarit është fakti se kjo gjykatë nuk e ka marrë si rrethanë rënduese recidivizmin në të gjitha rastet. Gjykata Themelore në Gostivar në shumicën e rasteve ka shqiptuar dënimin me gjobë dhe konsideroj se në disa raste siç janë recidivist është dashtë të shqiptoj edhe dënimin me burgim. Kjo mendoj që i inkurajon këta kryes që edhe në të ardhmen të vazhdojnë me kryerjen e kësaj veprë. Sikur dënimet të ishin më të ashpra, konkretisht dënimi me gjobë, i cili ka për qëllim ta godet standardin e kryesit ndoshta do të ndikonte në rënien e këtij lloji të kriminalitetit. Gjykata Themelore në Gostivar si dënime më të shpeshta ka shqiptuar dënimin me gjobë, dënimin me kusht e më pak dënimin me burgim. Por,

kam hasur dhe të kundërtën, kur gjykata është dashur të jep aktgjykim lirues për 3 bashkëkryes për sasi 0.01 gr. lëndë narkotike, ka shqipruar dënim për të tre bashkëkryesit. (Aktgjykimet e Gjykates themelore Gostivar, 2015-2020). Rrethanat lehtësuese poashtu janë të një rëndësie të vecant sa i përket matjes së dënimit dhe sjellin me vete një dënim më të butë për kryesin. Si rrethana lehtësuese Gjykata në Gostivar ka marr pranimin e fajësisë, gjendjen ekonomike të kryesve, korrektësinë e tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor etj.

# 1. Bibliografia

## Ligje dhe konventa ndërkombëtare:

- Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.150/2010
- Ligji për procedurë penale 1997
- Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.199, 30.12.2014
- Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.150/07
- Ligji për të drejtat e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.148/2003
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e KS-së,nr. K-09042008
- Kodi Penal i Kosovës, Gazeta Zyrtare e KS-së,nr [2/2019](#)
- Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, Gazeta Zyrtare e KS-së,nr.[37/2012](#)
- Komentari I KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVË nga Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija / Dr.Sc. Fejzullah Hasani
- Kodi penal i R. së Kroacisë
- Criminal Code, Class: 011-01/11-01/186 No.: 71-05-03/1-11-2 Zagreb, 26 October 2011
- Kodi I Procedurës Penale I Republikës së Shqipërisë, LIGJNr. 8116, datë 29.3.1996KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË(ndryshuar me ligjet nr. 8431, datë 14.12.1998; nr. 8491, datë 27.5.1999; nr. 8535, datë 18.10.1999; nr. 8812, datë 17.5.2001; nr. 9062, datë 8.5.2003; nr. 9953, datë 14.7.2008, nr. 10 052, datë 29.12.2008, nr. 49/2012,datë 19.4.2012; 122/2013, datë 18.4.2013; 160/2013, datë 17.10.2013; nr. 114/2016, datë 3.11.2016; nr. 38/2017, datë 30.3.2017, nr. 44/2021, datë 23.3.2021)
- Recommendation No. R (87) 18 concerning the simplification of criminal justice.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, Palermo, 2000

## Libra:

- Kambovski Vlado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2010

- Zejneli Ismail, Kambovski Vlado, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018
- Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë, Tetovë 2010
- Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Tetovë, 2007
- Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2018
- Sahiti Ejup, Murati Rexhep, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013
- Prof. dr. Vesel LATIFI – Prof. as. Dr. Agron BEKA, Vrasjet, Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi, Prishtinë, 2013,
- Prof. Dr. Rexhep Gashi, Krimi i Organizuar, Prishtinë 2011, fq.13 – 14
- Rober Badenter, Abolicija
- Zyra e OSBE-së për të drejta të Njeriut dhe Institucione Demokratike, Përmbledhje ligjore e të drejtave ndërkombëtare për gjykim të drejtë
- IOM Mission in Skopje, Penalty and Legal regulation and analysis of cases of Trafficking in human beings and migrants from Macedonia, Serbia, Albania, Montenegro ana Bosna and Herzegovina
- Kanuni i Lekë Dukagjinit
- Petar Novoselac, Opći dio kaznenog prava
- Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë

#### **Artikuj shkencor:**

- Ивона Шушак, Групно извршување на кривичните дела кај деца во Република Македонија за периодот од 2005-2015 година
- Arber Basholli - Bashkëpunimi i personave në kryerjen e veprës penale
- M-r Marjan Gaberov, Транснационален организиран криминалитет-трендови и случувања
- M-r Ebru Ibish, Криминолошки и казнено-правни аспекти на малолетничката деликвенција во Република Македонија
- Carlo FIORE – Stefano FIORE, Diritto penale, Botimi i III, Milano 2008
- Mantovani, Diritto Penale, parte generale, Padova ,2007



## Burime nga interneti:

- <http://www.vsrn.mk>
- <http://www.vsrn.mk/wps/portal/osgostivar>
- <http://www.vsrn.mk/wps/portal/asgostivar>
- <http://www.vsrn.mk/wps/portal/ostetovo>
- <https://jorm.gov.mk/>
- <https://jorm.gov.mk/osnovno-javno-obvinitelstvo-za-gonen/>
- [https://en.wikipedia.org/wiki/Capital\\_punishment\\_in\\_Europe#:~:text=As%20of%202019%2C%20in%20Europe,since%20either%201996%20or%201999.](https://en.wikipedia.org/wiki/Capital_punishment_in_Europe#:~:text=As%20of%202019%2C%20in%20Europe,since%20either%201996%20or%201999.)
- <https://www.sppmd.mk/>
- <http://www.pravo.org.mk/>
- <https://akademik.mk/>
- <https://www.diritto.it/vezhgim-mbi-kategorine-dogmatike-menytrat-e-shfaqes-se-vepres-penale/>
- <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fsites.google.com%2Fsite%2Fjuridikal%2Ffusha-te-se-drejtes%2Fe-drejta-penale>
- Kohn, Alfie (1992). *No Contest: The Case Against Competition*. Houghton Mifflin Harcourt. p. 19. [ISBN 978-0-395-63125-6](#)
- Wedekind, Claus; Milinski, Manfred (5 May 2000). "[Cooperation Through Image Scoring in Humans](#)". *Science*. **288** (5467):850–852. [Bibcode:2000Sci...288..850W](#). [doi:10.1126/science.288.5467.850](#). [ISSN 0036-8075](#). [PMID 10797005](#)
- <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.diritto.it%2Fvezhgim-mbi-kategorine-dogmatike-menytrat-e-shfaqes-se-vepres-penale%2F>
- <http://jus.igjk.rks-gov.net/727/1/Kodi%20Penal.pdf>
- <https://google.com/url?sa=D&q=http%3A%2F%2Fjus.igjk.rks-gov.net%2F670%2F2%2FBashk%25C3%25ABpunimi%2520n%25C3%25AB%2520kryerjen%2520e%2520vepr%25C3%25ABs%2520penale%20shqip.pdf>

- <https://www.zakon.hr/z/98/Kazneni-zakon>
- [https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi\\_Penal-1.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf)
- <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fknowledgecenter.ubt-uni.net%2Fcgi%2Fviewcontent.cgi%3Farticle%3D1376%26context%3Detd>
- <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/5d858e6fa8084b6cb6450d2b787aef83.pdf>
- <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Frm.coe.int%2F16806ed48b>
- [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.drejtesia.gov.al%2Fwp-content%2Fuploads%2F2017%2F11%2FKodi\\_Penal-1.pdf](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.drejtesia.gov.al%2Fwp-content%2Fuploads%2F2017%2F11%2FKodi_Penal-1.pdf)
- <http://jus.igjk.rks-gov.net/727/1/Kodi%20Penal.pdf>
- [https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/1993\\_04\\_32\\_574.html](https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/1993_04_32_574.html)